VITI MBAREKOMBETAR I GJERGJ KASTRIOTIT SKENDERBEUT - 2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

REPUBLIKA E KOSOVËS
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Nr.3144/1 Prot. Tiranë, më 08.05.2018

Nr.2372/01B Prot. Prishtinë,më 31.05.2018

KURRIKULA E MËSIMIT PLOTËSUES TË GJUHËS SHQIPE DHE TË KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË E NË MËRGATË

MIRATOHET

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

MIRATOHET

SHYQIRI BYTYQI

MINISTËR

Tiranë, Prishtinë, prill 2018

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË E KOSOVËS

KURRIKULA E MËSIMIT PLOTËSUES TË GJUHËS SHQIPE DHE TË KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË E NË MËRGATË

Prishtinë -Tiranë, 2018

Grupi i punës

Dokumenti "Kurrikula e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë e në mërgatë" u hartua nga:

- Nuhi GASHI, MASHT, Kosovë.
- Arbër Salihu, MASHT, Kosovë,
- Shqipe Gashi-Ramadani, MASHT, Kosovë,
- Feime Llapashtica-Lipscom, MASHT, Kosovë,
- Besa Luzha, MASHT, Kosovë,
- Erida Koleci, IZHA, Shqipëri,
- Ines Todhe, IZHA, Shqipëri,
- Evis Mastori, IZHA, Shqipëri,
- Elfrida Begaj, IZHA, Shqipëri,
- Albana Markja, IZHA, Shqipëri.

Redaktorë

- Nuhi Gashi, MASHT, Kosovë,
- Erida Koleci, IZHA, Shqipëri.

Ky dokument u hartua duke u mbështetur në "Kurrikulën e SHMPGJSH-së" (MASHT, Prishtinë, 2007), dhe në "Programin e integruar të mësimit shqip në diasporë" (MASH, Tiranë, 2010).

Përmbajtja

1. HYRJA 5
2. QËLLIMET E KURRIKULËS 6
3. PARIMET E PËRGJITHSHME 7
   3.1. Parimi i interesit kombëtar 7
   3.2. Parimi i gjithëpërfshirjes dhe i vijimësisë 7
   3.3. Parimi i ndërkulturorësisë 8
   3.4. Parimi i fleksibilitetit 8
   3.5. Parimi i integrimit 8
   3.6. Parimi i shumëllojshmërisë së metodave dhe të qasjeve 8
4. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS NIVELEVE 8
   4.1. Niveli i parë (Klasat I-III...) 8
   4.2. Niveli i dytë (Klasat IV-VI...) 9
   4.3. Niveli i tretë (Klasat VII-IX...) 9
5. TEMATIKAT DHE TEMAT MËSIMORE 10
   5.1. Identiteti im 10
   5.2. Shqiptarët në hapësirë dhe në kohë 10
   5.3. Shoqëria dhe kultura 10
   5.4. Një botë për të gjithë 10
   5.5. Mësimi, puna, loja, koha e lirë 11
6. REZULTATET DHE PËRMBAJTJET MËSIMORE SIPAS TEMATIKAVE 12
   6.1. Niveli i parë 12
   6.2. Niveli i dytë 21
   6.3. Niveli i tretë 31
7. UDHËZIME METODOLOGJIKE 42
   7.1. Gjuhë shqipe 45
   7.2. Histori 47
   7.3. Gjeografi 48
   7.4. Kulturë muzikore ..... **Error! Bookmark not defined.**
   7.5. Kulturë figurative 50
8. KUADRI MËSIMOR DHE PËRGATITJA 50
9. MJEDISI DHE MJETET MËSIMORE 51
10. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN 52
11. BURIMET E REKOMANDUARA TË TË NXËNIT 53
   11.1. Gjuhë shqipe 53
   11.2. Histori 57
   11.3. Gjeografi 58
   11.4. Kulturë figurative dhe kulturë muzikore 59
12. PLANI MËSIMOR ORIENTUES 62

1. HYRJA

*Kurrikula e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgat*ë[1] në radhë të parë u dedikohet fëmijëve dhe të rinjve (nxënësve) shqiptarë, të cilët jetojnë jashtë Atdheut të prejardhjes. Dokumenti synon ta plotësojë shkollimin e tyre të rregullt duke u ofruar një shkollim plotësues për gjuhën shqipe dhe për kulturën shqiptare. Po ashtu, kjo kurrikul, me qëllimet, rezultatet, përmbajtjet tematike dhe metodologjinë bashkëkohore ndërvepruese, është e hapur dhe e përshtatshme edhe për nxënësit e tjerë jo shqiptarë që shprehin interes për ta mësuar gjuhën dhe kulturën shqiptare.

Në kushtet e jetës jashtë Atdheut, mësimi i gjuhës amtare dhe ruajtja e zhvillimi i identitetit kombëtar vështirësohet dhe kjo manifestohet shumë më tepër te brezat e rinj, posaçërisht te fëmijët e lindur atje. Prandaj, institucioni më i përshtatshëm, ku mësohen e zhvillohen kompetencat gjuhësore e kulturore me përkujdesje profesionale, është shkolla. Së këndejmi, është hartuar edhe kjo kurrikul, e cila vjen si rezultat i një bashkëpunimi dhe konsultimi të gjatë mes specialistëve të fushës në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, mësueseve e mësuesve shqiptarë/e që punojnë me grupet e nxënësve shqiptarë gjithandej nëpër diasporat shqiptare dhe me qarqe e subjekte të tjera me interes. Po ashtu, janë marrë parasysh edhe kornizat kurrikulare të mësimit të gjuhës amtare dhe të kulturës së prejardhjes për nxënësit me sfond migrator të shteteve të ndryshme ku është e përqendruar diaspora ose mërgata shqiptare.

Dokumenti mëton të jetë një kurrikul bashkëkohore e orientuar përmes rezultateve të pritshme. Është hartuar për t'iu përshtatur kushteve dhe niveleve të ndryshme të zbatimit praktik. Për lehtësi kuptimi, interpretimi dhe zbatimi kjo kurrikul është strukturuar në qëllime, parime, përmbajtje, tematika e tema të caktuara dhe rezultate të pritshme. Në varësi të mundësive dhe të angazhimit të mësuesve dhe të prindërve, mësimi plotësues i fëmijëve mund të realizohet periodikisht në kohë dhe në hapësira të ndryshme sipas rrethanave e kushteve reale në shtetet përkatëse dhe atë: a) në shkollë (mjedise shkollore) brenda 36 javësh mësimore e me një numër prej 72 orësh mësimore në vit, dhe b) në shtëpi/familje e gjetiu sipas rrethanave konkrete.

Mësuesit mbajnë parasysh se brenda një mësimi të vetëm nxënës/i,-ja merr njohuri për letërsinë dhe artin, historinë dhe gjeografinë, kulturën dhe zakonet, si dhe fiton shprehi gjuhësore për t'i kuptuar dhe për t'i shprehur në mënyrë korrekte njohuritë dhe aftësitë që i propozohen.

Kurrikula shtjellohet përmes pesë tematikave, të cilat konceptohen në mënyrë të integruar e komplementare njëra me tjetrën: *Identiteti im, Shqiptarët në hapësirë dhe në kohë, Kultura dhe shoqëria, Një botë për të gjithë, Mësimi, puna, loja e koha e lirë*. Është e nevojshme të theksohet se tematikat shërbejnë si kuadër i përgjithshëm dhe i përbashkët në të cilin realizohet integrimi i fushave kurrikulare, meqenëse në praktikë ora mësimore nuk zhvillohet për njohuri të veçanta, por kombinon materialin e disa fushave kurrikulare së bashku (gjuhë shqipe, histori, gjeografi, kulturë muzikore dhe kulturë figurative), gjithnjë në përputhje me qëllimet e kësaj kurrikule.

Kompetencat e nxënësve zhvillohen përgjatë tri niveleve mësimore, duke respektuar gjithnjë specifikat e niveleve të shkollimit të sistemeve të vendeve përkatëse. Kryesisht, kjo

[1] Termat "*diasporë"* dhe "*mërgatë"* duhet të diferencohen; me *diasporë* nënkuptohen migrimet e hershme shqiptare ("përjetësia" e ngulitjes), kurse me *mërgatë* kryesisht migrimet e dy shekujve të fundit (përkohësia, ku ideali i rikthimit ushqehet edhe përmes lidhjes së qëndrueshme me pjesën e familjes dhe me pronën në Atdhe).

duket kësisoj: niveli i parë përfshin klasat I-III; niveli i dytë përfshin klasat IV-VI; niveli i tretë përfshin klasat VII-IX. Megjithatë, duke pasur parasysh kushtet reale në të cilat zhvillohet mësimi plotësues në vendet përkatëse, si dhe kompetencat paraprake të nxënësve, ky identifikim ose sistemim i klasave me këto tri nivele është shumë relativ. Në të vërtetë është mësuesi, ai që e organizon mësimin, dhe që në radhë të parë mbështetet në kompetencat reale paraprake të nxënësve për fusha të caktuara dhe në diferencimin e nevojshëm, prandaj ky mësim, varësisht prej rrethanave ose vendit ku zhvillohet, përfshin nxënës prej klasës I- XII.

Kurrikula ofron një formim të zgjeruar të nxënësve sipas niveleve, por është e domosdoshme që ky formim shkollor të vijojë të plotësohet me ndihmën e prindërve, më të rriturve etj., të cilët i krijojnë fëmijës një mjedis gjuhësor shqiptar në gjirin e familjes e të shoqërisë e sidomos mundësojnë që ai (fëmija) të motivohet më tepër nëpërmjet vizitave në vendin e prejardhjes dhe marrëdhënieve të drejtpërdrejta e të natyrshme që ai vetë vendos në këto raste.

Ky dokument përmban edhe udhëzimet e nevojshme metodike-didaktike, të specifikuara sipas fushave kurrikulare dhe veçorive të tyre dhe në harmoni me zhvillimet bashkëkohore në arsim, duke marrë për bazë interesat, mundësitë, aftësitë dhe moshën e nxënësve. Me qëllim krijimin e lehtësive të interpretimit dhe të zbatimit, në një masë të mjaftueshme, është bërë edhe një lloj specifikimi lëndor në kuptim të përmbajtjes dhe të rezultateve. Po ashtu, për të pasur parasysh edhe shkallën e përfshirjes përmbajtjesore, në krijimin e kësaj kurrikule në kontekstin e lëndëve/fushave kurrikulare është ndërtuar edhe plani orientues mësimor, i cili gjithnjë duhet të shqyrtohet nga mësuesi dhe t'i përshtatet rrethanave konkrete të mësimit.

Përveç se është pjesë e synimit të përhershëm për vetëdijesimin e vazhdueshëm të brezave të rinj për gjuhën dhe kulturën e prejardhjes, si përparësi dhe veçanti e identitetit të tyre personal e kolektiv kombëtar, në njërën anë, dhe si mbështetje e bazë e mirë për integrimin e tyre në shoqërinë ku jetojnë, në anën tjetër, mësimi që i referohet kësaj kurrikule, po ashtu, i hap shteg edhe synimit për kthim në Atdhe dhe integrim më të lehtë e më të natyrshëm në shoqërinë e tij.

Kjo kurrikul, si për nxënësit shqiptarë, ashtu edhe për të tjerët që dëshirojnë ta mësojnë gjuhën shqipe, përbën një mësim shtesë krahas mësimit të rregullt dhe është një mbështetje e mirë në formimin sa më të plotë të personalitetit të tyre, duke i zhvilluar dhe pasuruar kompetencat dhe potencialet intelektuale, estetike, morale dhe sociale, duke nxitur njëkohësisht komunikimin dhe bashkëpunimin në mes të kulturave të ndryshme.

Realiteti socio-psikologjik dhe kulturor i fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë në diasporë e në mërgatë kërkon mbështetjen e tyre për integrim në shoqërinë vendore, ku kompetenca për gjuhën dhe kulturën e prejardhjes, dygjuhësia, shumëgjuhësia e multikultura konsiderohen përparësi e zhvillimit personal e kolektiv në të gjitha fushat.

2. QËLLIMET E KURRIKULËS

Qëllimet e kësaj kurrikule janë:

- zhvillimi dhe ruajtja e identitetit kombëtar përmes mësimit të gjuhës[2], kulturës së prejardhjes, si dhe njohja me trashëgiminë dhe thesarin kulturor, natyror dhe historik kombëtar;

[22] Përveç dokumenteve e konventave ndërkombëtare e regjionale, që e mbrojnë gjuhën amtare, e të cilave njëkohësisht u referohet kjo kurrikul, në kalendarin kulturor të Evropës dhe të botës janë edhe disa data me interes, të cilat duhet të gjenden në planet e punës së mësuesve dhe duhet të shënohen me veprimtari konkrete.

- edukimi dhe zhvillimi i interesit për njohjen dhe përdorimin e gjuhës e të letërsisë shqipe në të gjitha rrethanat dhe ambientet e komunikimit;
- zgjerimi dhe thellimi i njohjes për thesarin shpirtëror, material, kulturor e historik kombëtar;
- zhvillimi i qëndrimit pozitiv për historinë dhe kulturën e kombit shqiptar, si pjesë përbërëse e qytetërimit evropian e botëror;
- zhvillimi e kultivimi i vazhdueshëm i ndjenjës së të qenit krenar për përkatësinë kombëtare dhe pjesë e hapësirës shpirtërore-kulturore unike shqiptare;
- krijimi dhe zhvillimi i kompetencave të domosdoshme gjuhësore e kulturore etnike, si bazë për integrim më të lehtë dhe të natyrshëm në shoqërinë vendore;
- krijimi i qëndrimit pozitiv ndaj shumëgjuhësisë dhe ndërkulturorësisë, si veçori të shoqërisë moderne multikulturore;
- përvetësimi dhe thellimi i vazhdueshëm i kompetencave gjuhësore e kulturore kombëtare, si nevojë e përparësi për kthim e integrim me të lehtë në atdheun e prejardhjes.

3. PARIMET E PËRGJITHSHME

Organizimi dhe mirëfunksionimi i kurrikulës së mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë kërkon që zhvillimi i saj të udhëhiqet nga disa pikënisje parimore. Parimet kryesore sipas të cilave zhvillohet kjo kurrikul janë si vijon:

3.1. Parimi i interesit kombëtar

Parimi i interesit kombëtar i referohet tri qëllimeve kryesore të kurrikulës të shprehura në raportet: shkolla dhe identiteti kombëtar, shkolla dhe integrimi, shkolla dhe kthimi në Atdhe[3]. Ky dokument paraqet një kornizë kurrikulare integruese, e cila përcakton të përbashkëtat kombëtare, qëllimet, kompetencat dhe rezultatet e pritshme.

Kurrikula, përveç se identifikon dhe përcakton minimumin e domosdoshëm të kompetencave në kuadër të synimit të ruajtjes dhe të zhvillimit të identitetit kombëtar dhe kulturor të shqiptarëve në diasporë e në mërgatë, merr parasysh dallimet ekzistuese juridike dhe administrative të shtrirjes hapësinore shumështetëshe të shqiptarëve.

3.2. Parimi i gjithëpërfshirjes dhe i vijimësisë

Kurrikula njeh, pranon, respekton dhe u përgjigjet nevojave, përvojave, interesave arsimore dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve, pavarësisht nga prejardhja ose veçoritë e tyre. Ky parim synon të ndërtojë një kurrikul që krijon mundësi të barabarta për sukses vetjak të çdo nxënësi.

Gjithëpërfshirja nënkupton kompaktësinë dhe integralitetin brenda hapësirës dhe identitetit kombëtar e kulturor dhe si e tillë shmang ndikimet e dallimeve të mundshme përjashtuese shtetërore, rajonale, fetare, gjinore etj.

Të tilla janë: 26 Shtatori - Dita Evropiane e Gjuhëve (Këshilli i Evropës) dhe 21 Shkurti- Dita Ndërkombëtare e Gjuhës Amtare (UNESCO).

[3] Duke qenë se hapësira etnike shqiptare shtrihet në disa shtete të Ballkanit, atëherë për lehtësi e saktësi komunikimi në vend të, p.sh., emërtimeve *Shqipëri*, *Kosovë* etj., varësisht prej konteksteve, është përdorur emërtimi *Atdhe*.

Gjithëpërfshirja në mësim, përveç fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë, nënkupton edhe të interesuarit joshqiptarë për mësimin e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare.

Më tej, nxënësit zhvillohen, nxënë në ritme dhe mënyra të ndryshme, duke i ndërtuar kompetencat e tyre mbi bazën e njohurive dhe të përvojës vetjake paraprake dhe ndjekjes së mësimit plotësues. Për këtë arsye, kurrikula hartohet dhe zbatohet në harmoni me veçoritë kryesore të grup-moshave, në varësi të mundësisë dhe të gatishmërisë së fëmijëve për të nxënë ose për të përvetësuar aftësi të caktuara. Në të njëjtën kohë, ajo ua bën të qartë nxënësve dhe prindërve të tyre drejtimin, nivelin dhe pikëmbërritjet e të nxënit në nivele të ndryshme arsimimi.

3.3. Parimi i ndërkulturorësisë

Të mësuarit në mjedise shumëkulturore e shumëgjuhëshe kërkon dhe mundëson ndërveprim të vlerave dhe të kulturave në përputhje me standardet e shkollës moderne dhe të shoqërisë së sotme globale. Pra, kjo kurrikul ka rol të veçantë në ndërtimin e kompetencës ndërkulturore të nxënësit.

3.4. Parimi i fleksibilitetit

Fleksibiliteti demonstrohet në raportin e hapur dhe ndërveprues me sistemin shkollor, me përmbajtjet kurrikulare dhe me vlerat e shoqërisë vendore. Duke marrë parasysh kushtet dhe rrethanat socio-kulturore, familjare e psikologjike të nxënësve shqiptarë në diasporë e në mërgatë, kjo kurrikul është e hapur dhe e përshtatur me kurrikulat vendore, dhe në një mënyrë e jo në pak raste dhe vende është pjesë përbërëse e tyre.

3.5. Parimi i integrimit

Kurrikula organizohet në tematika, të cilat kanë në themel ndarjen dhe integrimin real të fushave të dijes. Si e tillë, kurrikula duhet të sigurojë njëherësh baraspeshën ndërmjet njohurive e shkathtësive të secilës fushë, si dhe integrimin brenda dhe ndërmjet tyre.

Shkalla, thellësia dhe forma e integrimit kushtëzohen nga veçoritë e temave, aftësive, vlerave etj., të nevojshme për t'u integruar. Kjo do të thotë që integrimi është një proces dinamik, i cili varet nga nevojat në ndryshim të përvetësimit të njohurive dhe të shkathtësive dhe nga situatat e të nxënit.

3.6. Parimi i shumëllojshmërisë së metodave dhe të qasjeve

Respektimi dhe zgjedhja e lirë e metodave nënkupton raport të hapur ndaj të gjitha qasjeve, ku interes të veçantë paraqesin edhe përvojat e fituara të mësuesve në vendet përkatëse. Ky lloj mësimi kërkon shumëllojshmëri metodash dhe përgatitjen e nevojshme për realizimin e punës mbi bazën e qëllimeve të përgjithshme, të cilët përcaktojnë standardin e dijeve, shkathtësive, qëndrimeve etj. Të gjitha këto paraqesin faktorë me rëndësi të veçantë që ofrojnë modalitetet e nevojshme për realizimin e kurrikulës, duke respektuar dhe duke zbatuar rrugët dhe stilet e ndryshme individuale të të nxënit me nxënësin në qendër, rolin e tij aktiv e krijues (nxënësit si partnerë në mësim).

4. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS NIVELEVE

4.1. Niveli i parë (klasat I-III...)

Në përfundim të këtij niveli, nxënës/i/ja:

- komunikon në gjuhën shqipe për tema të ndryshme, përmes bisedës, përshkrimit gojor dhe formave artistike të të shprehurit (recitime, dialogë dhe këngë në përputhje me moshën dhe me interesat e tij) në nivelin e *përdorimit fillestar;*
- shkruan e lexon duke zbatuar rregullat themelore të drejtshkrimit dhe të drejtshqiptimit të gjuhës shqipe;
- ndërton drejt fjalitë e thjeshta dhe dallon fjalët e ndryshueshme në gjuhën standarde shqipe;
- përdor forma të ndryshme të të shprehurit krijues përmes *prezantimeve, bisedave, këngëve, vizatimeve* apo *punëve krijuese* për tema e për situata të ndryshme;
- këndon *këngën shqipe për fëmijë dhe popullore* në karakter, në intonacion dhe ritëm;
- përjeton vepra muzikore të kompozitorëve shqiptarë;
- identifikon vepra e krijues, përfaqësues të arteve pamore, muzikore etj., dhe i ndërlidh ato me njësitë tematike të caktuara;
- kupton dhe përdor termat, nocionet dhe konceptet themelore historike, gjeografike e kulturore të shoqërisë shqiptare, duke u nisur nga koncepti për familjen e deri te koncepti për atdheun e kombin.

4.2. Niveli i dytë (klasat IV-VI...)

Në përfundim të këtij niveli nxënës/i /ja:

- komunikon në nivel dhe në mënyrë *të pavarur* në gjuhën standarde shqipe, në kontekste të ndryshme në përputhje me moshën dhe interesin e tij/saj;
- shqipton e shkruan drejt dhe organizon logjikisht tekstin letrar ose jo letrar;
- dallon shqipen standarde nga dialektet dhe të folmet lokale (në të folur, në shkrime, në lexim etj.);
- krijon këngë, valle, lojëra, ornamente dhe veshje me motive tradicionale;
- luan në instrumente popullore muzikore;
- shpreh përjetimet, përshtypjet, qëndrimet, shqetësimet, gjykimet dhe vlerësimet nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit (me gojë e me shkrim, si dhe përmes formave të shprehjes artistike muzikore e figurative);
- krahason krijimet artistike në letërsi, muzikë dhe arte figurative nga autorët e vendit të prejardhjes dhe të vendit ku jeton;
- analizon dallimet dhe të përbashkëtat nga historia, gjeografia dhe artet e vendit ku jeton me ato të kombit shqiptar;
- përshkruan dhe diskuton ngjarje, vende dhe figura të rëndësishme të historisë kombëtare, duke hulumtuar e duke përdorur të dhëna e burime të ndryshme;
- dallon pozitën dhe shtrirjen natyrore e gjeografike të vendit të origjinës në hapësirën e sotme ballkanike, rajonale e evropiane;
- dallon dhe shpjegon veçoritë e veçantitë themelore të organizimit shoqëror e shtetëror të vendit të prejardhjes.

4.3. Niveli i tretë (klasat VII-IX...)

Në përfundim të këtij niveli nxënës/i /ja:

- komunikon në nivel *kompetent* në gjuhën standarde shqipe;
- shkruan drejt në gjuhën standarde shqipe në situata të ndryshme;
- përkthen tekste të thjeshta nga gjuha shqipe në gjuhën e vendit ku jeton dhe anasjellas;
- zbaton dhe përdor dijet për gjuhën e letërsinë shqipe në të gjitha veprimtaritë gjuhësore;
- lexon, komenton e interpreton autorët dhe veprat përfaqësuese të letërsisë shqipe dhe i krahason me letërsinë e vendit ku jeton dhe me ato evropiane e botërore;
- komenton veprat më përfaqësuese të krijimtarisë muzikore shqiptare dhe i krahason me ato të vendit ku jeton dhe me ato evropiane dhe botërore,

- vlerëson e komenton veprat më përfaqësuese të krijimtarisë shqiptare të arteve pamore dhe i krahason me vlerat e artit pamor të vendit ku jeton dhe ato evropiane dhe botërore;
- vlerëson trashëgiminë kombëtare (kulturore, natyrore, ekonomike etj.) dhe e krahason me atë të vendit ku jeton;
- dallon veçoritë gjeografike dhe të zhvillimit shoqëror e ekonomik të vendit të prejardhjes dhe lidhjet e këtij zhvillimi me vendin ku jeton e më gjerë;
- analizon dhe gjykon në mënyrë kritike proceset, ngjarjet dhe zhvillimet historike kombëtare shqiptare në raport krahasues me shoqërinë e vendit ku jeton dhe me zhvillimet globale.

5. TEMATIKAT DHE TEMAT[4] MËSIMORE

Kurrikula e mësimit plotësues të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë shtjellohet në 5 tematika kryesore, ku secila prej tyre sugjeron tema mësimore.

Ato janë emërtuar si më poshtë:

1. Identiteti im
2. Shqiptarët në hapësirë dhe në kohë
3. Kultura dhe shoqëria
4. Një botë për të gjithë
5. Mësimi, puna, loja, koha e lirë

5.1.Identiteti im

Përmes kësaj tematike nxënësi zbulon gradualisht dhe natyrshëm pjesën më të qenësishme të identitetit të vet, gjuhën shqipe me veçoritë e saj, zotërimi i së cilës e aftëson atë që të punojë me tekste letrare dhe jo letrare. Të gjitha fushat/lëndët e tjera formësojnë dhe plotësojnë më tej tek nxënësi, në mënyrë më të plotë, kuptimin e identitetit kombëtar shqiptar.

5.2. Shqiptarët në hapësirë dhe në kohë

Përmes kësaj tematike nxënësi njihet me koordinatat dhe me hartën e vendosjes hapësinore të shqiptarëve, si dhe me momentet kryesore të historisë së tyre përgjatë shekujve. Kjo tematikë aftëson nxënësin që të orientohet në mënyrë graduale, duke zotëruar të dhënat kryesore që lidhen me gjeografinë, historinë dhe kulturën shqiptare, me popullin shqiptar si formacion etnik dhe si njësi kombëtare.

5.3. Shoqëria dhe kultura

Përmes kësaj tematike nxënësi arrin të bashkërendojë të dhënat dhe njohuritë e domosdoshme mbi të cilat është ndërtuar shoqëria shqiptare që në kohën e ilirëve. Aty janë bashkërenditur historia, arti, muzika, zakonet dhe traditat, trashëgimia materiale e kulturore, monumentet e kulturës, parqet natyrore, vendet turistike etj.

5.4. Një botë për të gjithë

Përmes kësaj tematike nxënësi përdor njohuritë e marra për kulturën dhe historinë shqiptare, duke integruar dhe duke e parë Shqipërinë dhe shqiptarët si gjithë historitë dhe kulturat në botë.

---

[4] Në kuadër të këtyre tematikave e temave, hartuesi i tekstit mësimor dhe zbatuesit e kësaj kurrikule (*mësuesi, nxënësi*) përdorin edhe tekste të tjera letrare ose jo letrare, mjete dhe softuere multimediale, por gjithnjë në përputhje me qëllimet, parimet dhe kompetencat e përshkruara në këtë kurrikul.

5.5.Mësimi, puna, loja, koha e lirë

Përmes kësaj tematike nxënësi njihet më thellë me mësimin, shkollën, punën, lojën, kohën e lirë në Atdhe dhe i krahason me ato të vendit ku jeton e krijon, duke u përgatitur për një përfshirje më kompetente të vetes në ndërtimin dhe zhvillimin e këtyre veprimtarive. Në këtë mënyrë ai ndërtohet më tej në rrafsh kulturor dhe e stabilizon baraspeshën e duhur identitare. Gjithashtu, kjo tematikë krijon mundësi që nxënësi të pasurojë fjalorin me fjalë dhe terma që lidhen me mësimin, punën, lojën dhe kohën e lirë.

Nr.	***Tematikat***	***Temat mësimore***
1.	**IDENTITETI IM**	1.1. Unë jam shqiptar 1.2. Familja ime 1.3. Unë dhe bashkësia e ngushtë 1.4. Unë dhe bashkësia e gjerë 1.5. Unë dhe mjedisi 1.6. Atdheu
2.	**SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË**	2. 1. Vendlindja 2.2. Banimi dhe vendbanimi 2.3. Natyra, veçoritë fizike dhe gjeografike 2.4. Popullsia në atdhe, dendësia, migrimet 2.5. Shqiptarët nëpër kohë 2.6. Figura e personalitete të shquara shqiptare
3.	**KULTURA DHE SHOQËRIA**	3.1. Kultura e jetesës dhe e mirësjelljes 3.2. Të drejtat dhe përgjegjësitë 3.3. Institucionet shqiptare 3.4. Qytetërimi shqiptar, historia, shkenca, politika, arti dhe kultura 3.5. Shqiptarët në ditët e sotme
4.	**NJË BOTË PËR TË GJITHË**	4.1. Integrimet dhe globalizmi 4.2. Të ndryshëm dhe të njëjtë 4.3. Perspektivat e njerëzimit dhe shqiptarët
5.	**MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË**	5.1. Shkolla ime 5.2. Shkolla dhe komuniteti 5.3. Shkolla shqipe në Atdhe 5.4. Puna 5.5. Profesionet 5.6. Veprimtaritë ekonomike 5.7. Koha e lirë 5.8. Loja

6. REZULTATET DHE PËRMBAJTJET MËSIMORE SIPAS TEMATIKAVE

NIVELI I PARË

GJUHË SHQIPE
(*Përdorues elementar i gjuhës)*

TË DËGJUARIT		
PËRMBAJTJA MËSIMORE		**REZULTATET E TË NXËNIT**
Të dëgjuarit për të kuptuar	- Dëgjimi i bisedave të ilustruara, i tregimeve, i përrallave, i legjendave, i poezive etj. - Dëgjimi i teksteve që trajtojnë tema të përditshme, si: shkolla, mësimi, koha e lirë, argëtimi, mjedisi etj.	Nxënës/i /ja: - dëgjon dhe reflekton në biseda të shkurta, të cilat jepen me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme; - dallon fjalë dhe shprehje të përditshme që kanë lidhje me veten e tij, me familjen dhe me mjedisin që e rrethon; - u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit; - tregon shkurtimisht përmbajtjen e teksteve që dëgjon; - dallon çështjen kryesore në lajmërime ose në mesazhe që kanë gjuhë të thjeshtë dhe të qartë; - nxjerr informacionin kryesor nga pjesë të shkurtra të regjistruara, të cilat trajtojnë probleme të jetës së përditshme.
Të dëgjuarit e qëllimshëm	- Dëgjimi i teksteve që trajtojnë tema për shëndetin, mjedisin, të drejtat e fëmijëve, sëmundjet, dukuritë e natyrës, historinë e kombit shqiptar etj.	Nxënës/i /ja: - dëgjon me vëmendjen të tjerët dhe dallon timbret në të folurit e tyre; - dëgjon dhe reflekton për konceptin e kohës (*dje, sot, nesër*) dhe të hapësirës (*këtu, atje, andej, këndej, para, mbrapa*); - orientohet sipas udhëzimeve që i jepen për të shkuar nga një vend në një tjetër.
Të dëgjuarit e teksteve letrare dhe jo letrare	- Kujtime, rrëfime, dokumentarë të ndryshëm për traditat, veshjet, festat, doket e zakonet, sportin, muzikën etj. - Tekste letrare si këngë, legjenda, përralla, fabula, gjëegjëza, vjersha popullore dhe poezi, prozë.	Nxënës/i /ja: - dallon tekstet letrare nga ato jo letrare; - dallon disa nga tiparet kryesore të teksteve letrare dhe jo letrare; - dallon poezinë nga proza; - dallon tiparet kryesore të gjëegjëzës, të përrallës, të fabulës dhe të poezisë.

TË FOLURIT		
PËRMBAJTJA MËSIMORE		**REZULTATET E TË NXËNIT**
Organizimi i të folurit	- Paraqitja e vetes, e anëtarëve të familjes dhe e njerëzve të farefisit. - Përshkrimi i portretit fizik personal, emërtimi i pjesëve të trupit të njeriut, i ditëve të javës, i muajve dhe i stinëve të vitit, i kushteve të jetesës, i shkollës, i rutinës ditore, i orës etj. - Përshkrime të natyrës dhe të dukurive të ndryshme natyrore si: era, shiu, tërmeti, vullkanet etj. - Rrëfime të ndodhive të shkurtra personale. - Rrëfime të përrallave ose të tregimeve të shkurtra. - Prezantime rreth traditave, veshjeve, zakoneve dhe dokeve, figurave historike, sportit, muzikës etj. - Prezantime rreth një teme që paraqet interes për nxënësit.	Nxënës/i /ja: - përshkruan me fjali të thjeshta veten, të afërmit, kushtet e jetesës, natyrën, shkollën, rutinën ditore etj.; - përshkruan çfarë i pëlqen ose jo rreth diçkaje; - krahason objekte të ndryshme; - rrëfen ndodhi të shkurtra personale ose të dëgjuara; - rrëfen përralla ose tregime të shkurtra; - flet për traditat, veshjet, festat, doket dhe zakonet, figurat historike, sportin, muzikën etj.; - bën një prezantim të shkurtër lidhur me një çështje të jetës së përditshme dhe jep shkurtimisht arsye, shpjegime dhe gjykime.
Bashkëveprimi dhe diskutimi në grup	- Përshëndetjet, shprehjet e lamtumirës, falënderimet. - Ftesa dhe njoftime të shkurtra. - Komunikime që kanë lidhje me jetën e përditshme. - Komunikime me të afërmit me mjete të ndryshme multimediale.	Nxënës/i /ja: - prezanton veten, përshëndet dhe falënderon të tjerët; - merr pjesë në biseda të shkurtra; - pyet dhe u përgjigjet pyetjeve të thjeshta gjatë bashkëbisedimeve; - shkëmben informacion, mendime dhe ndjesi rreth temave të përditshme që kanë lidhje me shkollën, familjen dhe kohën e lirë; - mëson të shkruajë dhe t'u përgjigjet ftesave, si dhe të kërkojë të falur; - shpreh mendimin e tij për situata të thjeshta të jetës së përditshme; - komunikon me të tjerët nëpërmjet teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (telefon, internet etj.).

TË LEXUARIT		
PËRMBAJTJA MËSIMORE		**REZULTATET E TË NXËNIT**
Të lexuarit fillestar	- Shkronjat e alfabetit dhe tingujt (të mëdha e të vogla). - Zanore. - Bashkëtingëllore. - Rrokje. - Fjalë. - Tiparet dalluese të fjalisë (fillimi me shkronjë të madhe dhe shenja e pikësimit në fund të saj).	Nxënës/i /ja: - lexon drejt shkronjat e alfabetit; - dallon shkronjat e mëdha nga shkronjat e vogla të gjuhës shqipe; - dallon zanoret dhe bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe; - përdor lidhjen mes shkronjës dhe tingullit për të lexuar dhe kuptuar fjalë të reja; - shqipton drejt tingujt, rrokjet dhe fjalët; - identifikon tiparet dalluese të një fjalie si: shkronja e madhe në fillim të saj, shenja e pikësimit në fund.
Të lexuarit për të kuptuar	- Tekste që pasqyrojnë traditat, veshjen, festat, historinë, doket dhe zakonet, sportet dhe artet shqiptare ose që përshkruajnë figura ose personalitete historike.	Nxënës/i /ja: - pyet për t'u sqaruar rreth përmbajtjes së një teksti ose rreth fjalëve të panjohura për të *(Ku? Kur? Pse? Si ndodh kjo? Çfarë do të thotë?*); - rilexon tekstin për ta kuptuar më mirë atë (*kur është e nevojshme*); - nënvizon gjatë leximit pjesët më të rëndësishme ose pjesët që i pëlqejnë më shumë (*me ndihmën e mësuesit*); - tregon shkurtimisht dhe me fjalë të thjeshta brendinë; - përmend çështjet kryesore, duke dhënë shembuj ose ilustrime nga teksti; - lidh pjesën që lexon me filma që ka parë, me udhëtime, me përvoja personale ose me tekste të lexuara më parë; - shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon me ndihmën ose nxitjen e mësuesit.
Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	- **Lexim tekstesh letrare:** përralla të shkurtra, fabula dhe tregime me figura, gjëegjëza, poezi të thjeshta. - **Lexim tekstesh jo letrare:** kartolina, letra të thjeshta, rregulla të thjeshta praktike, ditar, orar mësimesh, reklama. - Njohuri të thjeshta për tiparet e teksteve të mësipërme.	Nxënës/i /ja: - lexon poezi, përralla nga folklori, përralla nga autorë të ndryshëm, tregime, fabula, gjëegjëza etj.; - përcakton dy-tri tipare kryesore të përrallave, fabulave, tregimeve, poezive; - përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara; - dallon elemente të tekstit, të tilla, si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu; - krahason poezinë me gjëegjëzën, përrallën me tregimin; - lexon tekste jo letrare si: ditar, kalendar i thjeshtë, kartolina, letra, lista, orare, reklama etj.

TË SHKRUARIT		
PËRMBAJTJA MËSIMORE		**REZULTATET E TË NXËNIT**
Të shkruarit fillestar	- Shkrimi i shkronjave të gjuhës shqipe. - Shkrimi i fjalëve 3-4 rrokëshe. - Shkrimi i fjalive dhe vendosja e shenjës së pikësimit në fund të saj.	Nxënës/i /ja: - dallon dhe shkruan shkronjat e gjuhës shqipe; - tregon me saktësi lidhjen shkronjë- tingull; - respekton hapësirën mes shkronjave, fjalëve dhe fjalive; - plotëson pjesët që u mungojnë fjalëve ose fjalive; - shkruan fjalë me tri - katër rrokje; - kopjon pjesë që kanë dialog deri në 3-4 fjali; - shkruan fjalë dhe fjali me të diktuar; - u përgjigjet me shkrim pyetjeve të thjeshta.
Të shkruarit për qëllime personale	- Shkrimi i tregimeve të thjeshta nisur nga disa ilustrime. - Përshkrime të ndryshme. - Hyrje dhe mbyllje përrallash dhe tregimesh. - Shkrime ngjarjesh ose ndodhish personale.	Nxënës/i /ja: - shkruan tregime të thjeshta, nisur nga figurat e dhëna; - përshkruan me fjalët e tij si e kupton një pikturë, një pamje apo një fotografi; - shkruan hyrje dhe mbyllje të tjera të një tregimi ose të një përralle; - përshkruan shokë, miq, të afërm, personazhe, objekte, sende e kafshë; - rrëfen ngjarje e përvoja personale duke u ndihmuar nga pyetjet: *Kush? Cili? Çfarë? Si? Kur? Ku?*.
Të shkruarit për qëllime funksionale	- Shkrime urimesh, kartolinash, letrash, duke përdorur një modele të thjeshta. - Shkrimi i një plani të thjeshtë të regjimit ditor.	Nxënës/i /ja: - shkruan tekste të shkurtra si: një urim, një kartolinë, një letër drejtuar një shoku duke përdorur një model të thjeshtë; - harton një plan të thjeshtë të regjimit ditor.

GRAMATIKË *(Njohuritë dhe konceptet gramatikore trajtohen duke u integruar me të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit)*	
PËRMBAJTJA MËSIMORE	**REZULTATET E TË NXËNIT**
- Alfabeti i gjuhës shqipe. - Zanoret dhe bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe. - Emrat dhe mbiemrat. - Numri njëjës dhe shumës i emrave dhe i mbiemrave (*lule e bardhë, lule të bardha).* - Trajta e shquar dhe trajta e pashquar e emrave. - Gjinia femërore dhe gjinia	Nxënës/i /ja: - njeh dhe dallon shkronjat e gjuhës shqipe; - lexon dhe shkruan zanoret dhe bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe; - dallon dhe përdor në fjali emrat në numrin njëjës dhe në numrin shumës; - përshtat mbiemrin me emrin, kur ndërton fjali të ndryshme; - përcakton trajtën e emrave (e shquar dhe e pashquar);

mashkullore e emrave. - Përemrat dëftorë (*ky/kjo/këta/këto*), përemrat pyetës, përemrat vetorë. - Numërorët në gjuhën shqipe (*1-100; qindëshet, mijëshet etj.*), themelorë dhe rreshtorë. - Zgjedhimi i foljes ndihmëse *jam*, koha e tashme e mënyrës dëftore. - Forma pohore, pyetëse dhe mohore e foljes *jam* (*Unë jam. A jam unë?Nuk jam unë.).* - Zgjedhimi i foljes *flas* në kohën e tashme të mënyrës dëftore. - Zgjedhimi i foljeve në kohën e tashme të mënyrës dëftore si p.sh.: *kam, lexoj, dëgjoj, pyes* etj.	- përdor emrat në trajtën e duhur, kur ndërton fjali; - dallon dhe përdor në fjali emrat në gjininë mashkullore dhe në gjininë femërore; - ndërton fjali me përemrat dëftorë (*ky/kjo/këta/këto*); - dallon përemrat pyetës; - ndërton fjali pyetëse me përemra pyetës; - dallon dhe përdor në fjali përemrat vetorë; - njeh dhe përdor si duhet numërorët në gjuhën shqipe; - zgjedhon foljen ndihmëse *jam* në kohën e tashme të mënyrës dëftore; - përdor foljen *jam* në fjali dëftore, pyetëse dhe pohore e mohore; - zgjedhon foljen *flas* në kohën e tashme të mënyrës dëftore; - zgjedhon foljet: *kam, lexoj, dëgjoj, pyes* në kohën e tashme të mënyrës dëftore, si dhe i përdor saktë ato në fjali të ndryshme.

HISTORI

TEMATIKA	PËRMBAJTJA MËSIMORE	REZULTATET E TË NXËNIT
IDENTITETI IM	- Unë dhe familja ime. Koha kur gjyshërit e mi ishin të rinj. - Pema e familjes sime. *(Kush jam unë? Ku kam lindur? Ku kanë lindur gjyshërit e mi? Nga e kam prejardhjen?Cilat janë ngjarjet e mia më të rëndësishme dhe të familjes sime?)*	Nxënës/i /ja: - mbledh, diskuton dhe krahason objekte të thjeshta nga e kaluara e tij/saj dhe e gjyshërve apo e të afërmve të tij/saj (*fotografi apo veshje);* - shqyrton aspekte të jetës së gjyshërve të tij/saj, kur ata ishin të rinj (*ku jetonin, banesat, rrobat dhe ushqimin, si udhëtonin, kërcimet, këngët, festat dhe festimet)*; - krahason aspekte të jetës së gjyshërve të tij/saj me aspekte të jetës së tij/saj sot, duke vënë në dukje dallimet dhe ngjashmëritë; - diskuton me gjyshërit e tij/saj për të kaluarën dhe vendin e prejardhjes së tyre; - ndërton një pemë të thjeshtë familjare me fotografi; - tregon apo shkruan thjesht historinë e familjes së tij/saj sipas kronologjisë.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	- Qyteti, vendi ku unë jetoj tani. - Vendi im i prejardhjes dhe i lindjes së të parëve të mi.	Nxënës/i /ja: - krahason qytetin, vendin ku ai/ajo jeton tani, me vendin e tij/saj të prejardhjes; - tregon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet qytetit, vendit ku ai/ajo jeton tani me vendin e tij/saj të prejardhjes;

		- shqyrton dhe krahason aspekte të jetës së vendit ku ai/ajo jeton me aspekte të jetës të vendit të tij/saj të prejardhjes; - tregon dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet tyre.
KULTURA DHE SHOQËRIA	- Festat dhe festimet në vendin tim të prejardhjes. - Kontributi i njerëzve të njohur në vendin tim të prejardhjes në kulturë, art, arsim, shkencë, si dhe në zhvillimet shoqërore dhe politike). *(Cilat janë festat që unë dhe familja ime festojmë sot dhe cilat nga këto festa i përkasin vendit tim të prejardhjes? Kush janë njerëzit e njohur që kanë kontribuar për zhvillimin e vendit tim të prejardhjes?)*	Nxënës/i/ja: - krahason lojërat që luan ai/ajo tani dhe festat dhe festimet kryesore të vendit të tij/saj të prejardhjes; - mëson këngë dhe valle të vendit të tij/saj të prejardhjes që luhen gjatë festimeve të festave kombëtare dhe tradicionale; - dëgjon dhe diskuton histori të thjeshta nga jetët e njerëzve, të cilët kanë dhënë kontribut në vendin e prejardhjes së tij/saj; - dëgjon dhe diskuton histori të thjeshta për jetën e njerëzve në vendin e tij të prejardhjes.
NJË BOTË PËR TË GJITHË	- Të ndryshëm, por të barabartë. - Bota, pjesë e jetës sime. *(Cila është origjina e shokëve të shkollës sime? Cila është gjuha dhe besimi i tyre?)*	Nxënës/i /ja: - diskuton për origjinën, traditat dhe besimet e ndryshme të shokëve të tij/saj të shkollës, si dhe dallon ndryshimet dhe të përbashkëtat ndërmjet tyre; - respekton origjinën, besimin, traditat, kulturën e shokëve/shoqeve të tij/saj; - dallon se njerëzit ndryshojnë, por njëkohësisht marrin e japin nga kultura e njëri- tjetrit; - paraqet veten si pjesë e botës që e rrethon.
MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË	- Shkolla ime. - Shkolla e prindërve dhe e të afërmve të mi. - Lojërat dhe hobi im i rregullt. - Lojërat e të parëve në vendlindje. (*Cilat janë lojërat*	Nxënës/i /ja: - përshkruan shkollën e tij/saj në vendin ku ai/ajo jeton tani me atë në vendin e prejardhjes, identifikon ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre; - përshkruan dallimin e shkollës së prindërve dhe të afërmve të tij me shkollën e tij; - identifikon dhe përshkruan disa nga lojërat që ai luan me lojërat e vendit të prejardhjes;

	që luajmë sot dhe ato që kanë luajtur gjyshërit e mi?). - Profesionet rreth nesh. (*Çfarë punojnë njerëzit këtu dhe në vendin e prejardhjes?).*	- krahason lojërat që luan ai tani me disa nga lojërat tradicionale më të njohura nga prindërit ose gjyshërit e tij, duke evidentuar dallimet dhe ngjashmëritë; - dallon dhe krahason disa nga punët dhe profesionet që i përkasin vendit që ai/ajo jeton tani dhe vendit të prejardhjes.

GJEOGRAFI

TEMATIKAT	**PËRMBAJTJET MËSIMORE**	**REZULTATET E TË NXËNIT**
IDENTITETI IM	- Vendi ku kam lindur (*rruga, vendbanimi, fshati/qyteti, rajoni, shteti*). - Vendlindja e të parëve të mi: prindërit, gjyshja, gjyshi (fshati, qyteti, krahina, rajoni).	Nxënës/i /ja: - përshkruan veçoritë gjeografike të vendit ku banon (*fushat, malet, luginat, detet, vendbanimet etj*.); - përshkruan vendin e prejardhjes së të parëve, vendndodhjen, veçoritë gjeografike të tij (*fushat, malet, luginat, detet, vendbanimet etj*.); - përdor harta, vizatime, fotografi për të treguar vendin e prejardhjes me tiparet dalluese të tij.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	- Veçoritë natyrore të vendit të prejardhjes (*relievi, klima, ujërat, bimët, kafshët, bukuritë natyrore*).	Nxënës/i /ja: - krahason peizazhin natyror të vendit të prejardhjes dhe atij të banimit, duke identifikuar të përbashkëtat dhe të veçantat e tipareve natyrore dhe mjediseve jetësore; - përdor fotografi, harta, vizatime dhe mjete të tjera për të interpretuar bukuritë natyrore të vendit të prejardhjes së të parëve.
KULTURA DHE SHOQËRIA	- Mënyra e jetesës, kultura, festat.	Nxënës/i /ja: - sjell shembuj të tipareve të përbashkëta të mënyrës së jetesës; - liston disa ndër festat familjare dhe kombëtare.
NJË BOTË PËR TË GJITHË	- Popuj të ndryshëm, shtete të ndryshme. - Ruajtja dhe mbrojtja e natyrës dhe e mjedisit jetësor.	Nxënës/i /ja: - identifikon disa shtete e popuj të botës; - përshkruan disa nga veprimet konkrete që ai/ajo dhe bashkëmoshatarët e tij/saj i bëjnë për të ruajtur mjedisin.
MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË	- Çfarë punojnë njerëzit në vendin e prejardhjes (*veprimtaritë dhe profesionet*)?	Nxënës/i /ja: - dallon veprimtaritë kryesore ekonomike me të cilat merret popullsia e vendit të prejardhjes, duke emërtuar disa nga të përbashkëtat dhe të veçantat mes vendit të prejardhjes dhe vendit të banimit;

KULTURË FIGURATIVE

TEMATIKA	PËRMBAJTJA MËSIMORE	REZULTATET E TË NXËNIT
IDENTITETI IM	- Vetja ime (*autoportret*). - Familja ime (*portret/e*). - Atdheu im i prejardhjes. - Flamuri kombëtar dhe shtetëror.	Nxënës/i /ja: - vizaton autoportretin, duke përshkruar tiparet dalluese; - vizaton portretet e anëtarëve të familjes së vet, duke përdorur mjete dhe materiale të ndryshme: *laps të zi, lapsa me ngjyra, akuarel etj.*; - vizaton ose kompozon peizazhe të thjeshta nga natyra shqiptare, duke përdorur materiale të ndryshme: *lapsa me ngjyra, akuarele, pastele;* - vizaton flamurin kombëtar dhe shtetëror shqiptar, duke kuptuar simbolin që përfaqëson një komb; - krijon mbi këto tema në mënyrë të pavarur, duke përdorur mjete e teknika te ndryshme.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	- Njerëz të shquar të kombit. - Natyra shqiptare në stinë të ndryshme. - Sportisti i parapëlqyer shqiptar.	Nxënës/i /ja: - bën portrete të njerëzve të shquar dhe të personaliteteve shqiptare; - krijon peizazhe me motive shqiptare duke u mbështetur në imazhe, fotografi etj.; - vizaton portretin e sportistit të vet të parapëlqyer shqiptar; - krijon mbi këto tema në mënyrë të pavarur, duke përdorur mjete e teknika të ndryshme.
KULTURA DHE SHOQËRIA	- Veshja tradicionale shqiptare. - Instrumente popullore muzikore shqiptare. - Ilustrime të përrallave shqiptare, si: *Gishtëza, E Bukura e Dheut.*	Nxënës/i /ja: - identifikon veshjet popullore shqiptare, duke përshkruar karakteristikat e tyre, (mund të përdoren albume etnografike, katalogë etj.); - vizaton motive të thjeshta, të marra nga elemente të veshjeve popullore shqiptare si: jelekët, xhoket, këmishët etj., duke evidentuar ngjyrat, simbolikën dhe karakteristikat e tyre; - vizaton veglën muzikore të parapëlqyer në familjen dhe mjedisin e tij më të ngushtë; - ilustron sipas imagjinatës së vet një përrallë shqiptare; - krijon mbi këto tema në mënyrë të pavarur dhe duke përdorur mjete e teknika të ndryshme.

NJË BOTË PËR TË GJITHË	- Portreti i shokut/shoqes karakteristikat. - Urim shokut/shoqes tim/sime në Atdhe (kartolinë).	Nxënës/i /ja: - realizon portretin e shokut/shoqes duke vënë në pah tiparet e tij/saj; - realizon një kartolinë urimi me rastin e festave kombëtare për shokët apo të afërmit që ka në Shqipëri; - krijon mbi këto tema në mënyrë të pavarur dhe duke përdorur mjete e teknika te ndryshme.
MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË	- Shkolla në Atdhe. - Lojërat në Atdhe. - Ornamentet, zejet dhe veprimtaritë prodhuese.	Nxënës/i /ja: - shprehet në mënyrë krijuese në forma të thjeshta me mjete e materiale të zgjedhura.

KULTURË MUZIKORE

TEMATIKA	**PËRMBAJTJA MËSIMORE**	**REZULTATET E TË NXËNIT**
IDENTITETI IM	- Kënga "*Betimi mbi flamur" (Himni i flamurit).* - Këngë të ndryshme për Atdheun. - Këngë dhe lojëra muzikore (autoriale dhe popullore).	Nxënës/i /ja: - këndon dhe interpreton himnin shqiptar në intonacion dhe ritëm; - këndon këngën për atdheun me emocion dhe intocionin e duhur; - këndon dhe shoqëron me lëvizje këngët dhe lojërat muzikore (autoriale dhe popullore).
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	- Këngë shqiptare për fëmijë me tematikë nga shkolla, familja, shokët, Atdheu.	Nxënës/i /ja: - këndon këngë me tematika të ndryshme nga realiteti shqiptar; - dëgjon këngë nga interpretues shqiptarë të këngës për fëmijë; - njeh kompozitorë të këngës shqiptare për fëmijë.
KULTURA DHE SHOQËRIA	- Këngët, lojërat popullore dhe ritet si elementet e trashëgimisë kulturore shpirtërore shqiptare: R*rodhe - rrodhe kokorodhe; Shi shi lagashi etj*. - Muzika shqiptare në festat familjare.	Nxënës/i /ja: - këndon dhe luan këngët, lojërat popullore dhe ritualet muzikore për fëmijë; - shoqëron me veprime lëvizore ritualet dhe këngët lojë, duke njohur qëllimin që ato kishin; - dallon muzikën festive; - interpreton këngët me karakter festiv; - shpreh mendimin rreth muzikës që e shoqëron në festat e tij/saj familjare; - shpreh përshtypjet e tij/saj për muzikë apo këngë të ndryshme shqiptare që këndohen gjatë festave familjare.

NJË BOTË PËR TË GJITHË	- Kënga "*Vëlla i dashur ' ('Vëlla Alban*") këngë të njëjta në gjuhë të ndryshme.	Nxënës/i /ja: - këndon këngën "*Vëlla Alban*" në shqip dhe në gjuhën e vendit ku jeton; - kupton që muzika është mjet komunikimi ndërmjet njerëzve; - kupton që ka këngë që këndohen nga të gjithë popujt në gjuhë të ndryshme.
MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË	- Këngë për shkollën, mësuesit, punën. - Lojërat tona popullore. - Muzikë për kohën e lirë.	Nxënës/i /ja: - këndon sipas prirjes individuale; - kujton ndonjë element të veprave muzikore që ka dëgjuar.

NIVELI I DYTË

GJUHË SHQIPE
(*Përdorues i pavarur i gjuhës*)

TË DËGJUARIT		
PËRMBAJTJA MËSIMORE		**REZULTATET E TË NXËNIT**
Të dëgjuarit për të kuptuar	- Dëgjimi i rrëfimeve nga mësuesi, shokët dhe shoqet e klasës, familjarët dhe të afërmit për jetën, vendlindjen, atdheun dhe përkatësinë kombëtare. - Dëgjimi i teksteve që trajtojnë tema të tilla si: shkolla, mësimi, koha e lirë, argëtimi, mjedisi jetësor.	Nxënës/i /ja: - tregon njohuritë e mëparshme që ka rreth temës ose përmbajtjes së tekstit që dëgjon; - reflekton për atë që thotë mësuesi ose folës të tjerë në klasë dhe në mjediset shkollore; - është i vëmendshëm ndaj atyre që flasin me të, i respekton dhe bisedon me ta; - kupton çështjet kryesore të teksteve të shkurtra që trajtojnë tema që kanë lidhje me shkollën, kohën e lirë, leximet etj; - shprehet për përmbajtjen dhe informacionin kryesor të materialeve të ndryshme, të regjistruara apo transmetuara, kur ato lidhen me fusha që përkojnë me interesat dhe karakteristikat e moshës.
Të dëgjuarit e qëllimshëm	- Dëgjimi i teksteve që trajtojnë tema si: mjedisi, të drejtat e fëmijëve, sëmundjet, luftërat etj.	Nxënës/i /ja: - kupton njoftimet dhe mesazhet për çështje të ndryshme, të dhëna me gjuhë standarde; - ndjek dhe kupton udhëzime të thjeshta, si p.sh., për përdorimin e pajisjeve të thjeshta; - shpreh përjetimet dhe emocionet që e kanë shoqëruar gjatë shikimit të një filmi ose dokumentari, dëgjimit të një tregimi, romani fabule apo përralle; - lidh informacionin e dëgjuar me përvojat e tij ose me informacione që i ka lexuar në tekste të tjera; - bën gjykime të thjeshta rreth tekstit;

		- identifikon mesazhin; - veçon disa detaje interesante (muzika që shoqëron rrëfimin e një përralle, zëri i personazheve etj.) gjatë të dëgjuarit.
Të dëgjuarit e teksteve letrare dhe jo letrare	- Dëgjimi i teksteve jo letrare të karakterit informues, didaktik, shkencor, mjedisor, etik, edukativ dhe historik për traditat, veshjen, festat, doket dhe zakonet, hapësirën urbane, bukuritë natyrore, sportin, muzikën etj. - Dëgjimi i teksteve letrare si: këngë popullore, legjenda, përralla, gjëegjëza, poezi, prozë dhe pjesë dramatike.	Nxënës/i /ja: - dallon tekstet jo letrare nga tekstet letrare, si p.sh., një rrëfim personal nga një tregim letrar ose një rrëfim historik nga një legjendë; - dëgjon dhe dallon ritmin e poezisë, tiparet kryesore të prozës, si dhe dialogun dhe monologun në një pjesë dramatike; - përcakton tiparet kryesore të legjendave, përrallave, tregimeve, pjesëve dramatike etj (*ndihmuar edhe nga njohuritë që merr në lëndën e gjuhës në vendin ku jeton*).

TË FOLURIT		
PËRMBAJTJA MËSIMORE		**REZULTATET E TË NXËNIT**
Organizimi i të folurit	- Përshkrime të vendlindjes, të prindërve dhe të të afërmve. - Përshkrime të ëndrrave dhe dëshirave . - Tregime të përmbajtjes së filmave ose librave të ndryshëm. - Rrëfime ngjarjesh reale ose të imagjinuara. - Prezantime rreth një përvoje personale ose rreth origjinës së familjes. - Prezantime të krijimeve folklorike shqiptare. - Tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare që trajtojnë tema që kanë lidhje me traditat, veshjen, festat, sportin, muzikën, doket dhe zakonet, ngjarjet, vendet dhe figurat historike, hapësirën urbane dhe	Nxënës/i /ja: - shpreh mendimet dhe ndjenjat e tij/saj me një gjuhë të saktë e të kuptueshme; - bën përshkrime të qarta dhe të detajuara duke nënvizuar idetë kryesore; - përshkruan ëndrrat, pasionet, shpresat dhe ambiciet e tij; - rendit në mënyrë të logjikshme ngjarjet ose episodet në rrëfime dhe tregime të ndryshme; - tregon përmbajtjen e një filmi ose të një libri; - rrëfen ngjarje reale ose të imagjinuara; - bën një paraqitje të thjeshtë për të treguar një përvojë të tij, duke e shoqëruar me mjete pamore si: posterë, harta, lista, foto etj., (*kur është e mundur edhe me ndihmën e kompjuterit*); - paraqet një krijim nga letërsia gojore shqiptare; - bën njoftime të shkurtra dhe jep udhëzime të ndryshme; - jep argumente me një gjuhë të thjeshtë në lidhje me një temë të caktuar; - reciton pjesë të mësuara përmendësh;

	bukuritë natyrore nga kanë ardhur dhe ku jetojnë.	- përdor mirë gjuhën standarde gjatë të folurit.
Bashkëveprimi dhe diskutimi në grup	- Biseda, diskutime dhe debate për tema të caktuara (shkolla, mësimi, ndarja e punëve sipas moshës, koha e lirë, argëtimi, mjedisi, të drejtat e fëmijëve, sëmundjet, luftërat etj.); - Biseda për pasuritë natyrore dhe ekonomike të vendeve të prejardhjes dhe ku jetojnë. - Format e ndryshme të komunikimit (internet, telefon, faks, celular dhe forma tjera).	Nxënës/i /ja: - flet rrjedhshëm dhe pa ndrojtje në biseda të zgjeruara për çështje dhe tema të ndryshme; - shpreh idetë e tij/saj në mënyrë të saktë dhe iu përgjigjet argumenteve me gjuhë bindëse; - diskuton rreth temave të ndryshme duke komentuar, duke nxjerrë konkluzione dhe duke vlerësuar mendimet e të tjerëve.

TË LEXUARIT		
PËRMBAJTJA MËSIMORE		**REZULTATET E TË NXËNIT**
Të lexuarit për të kuptuar	- Tekste që pasqyrojnë traditat, veshjen, festat, doket dhe zakonet, ngjarjet, vendet dhe figurat historike, hapësirën urbane dhe bukuritë natyrore, sportin, muzikën etj.	Nxënës/i /ja: - lexon rrjedhshëm tekste të ndryshme; - parashikon se çfarë do të ndodhë në tekst, duke u bazuar në atë që ka lexuar më parë (*lexim i drejtuar*); - gjen në fjalor kuptimin e fjalëve të panjohura që lexon; - u përgjigjet pyetjeve të mësuesit rreth brendisë së tekstit; - tregon përmbajtjen e tekstit që lexon; - përmbledh idetë kryesore duke i ilustruar me fragmente dhe detaje nga teksti; - lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën dhe leximet e mëparshme ose dukuri të jetës së përditshme; - gjykon me argumente të thjeshta idetë dhe informacionin e tekstit; - krahason në një tekst dy ose më shumë ide, koncepte, detaje etj.
Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare	**Lexim tekstesh letrare**: poezi të thjeshta, fabula, përralla, tregime, fragmente romanesh ose tregimesh nga letërsia shqiptare. **Lexim tekstesh jo**	Nxënës/i /ja: - lexon rrjedhshëm tekste letrare si: poezi, këngë popullore, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, mite, romane për fëmijë, tekste dramatike; - dallon temat ose idetë kryesore në tekstet letrare (poezi, prozë ose tekste dramatike); - tregon pjesën që i pëlqen më shumë dhe është më e

	letrare: artikuj nga gazeta dhe revista, udhëzime të thjeshta, porosi, fletë ditari, letra, biografi etj.	këndshme për të, si dhe argumenton pëlqimin e tij/saj; - lexon tekste jo letrare si: udhëzime të shkurtra, shënime, sqarime, njoftime, letra formale, artikuj në gazeta dhe në revista për fëmijë; - dallon temat ose idetë kryesore në tekstet jo letrare; - kupton funksionet e elementeve grafike të disa teksteve si: hartat, tabelat, ilustrimet etj.

TË SHKRUARIT		
PËRMBAJTJA MËSIMORE		**REZULTATET E TË NXËNIT**
Të shkruarit për qëllime personale	- Përshkrime të ndryshme. - Rrëfime ngjarjesh. - Shkrimi i biografisë dhe i autobiografisë. - Shkrime letrash personale. - Ditar. - Poezi të thjeshta etj.	Nxënës/i /ja: - përshkruan natyrën, vendlindjen, fëmijërinë e tij etj.; - përshkruan personazhet që pëlqen; - rrëfen ngjarje, shpreh ndjenja, përcjell ide rreth botës reale dhe imagjinare; - shkruan një biografi ose një autobiografi të shkurtër; - shpreh me shkrim ndjenjat dhe përjetimet që i ngjall një poezi, një tregim etj.
Të shkruarit për qëllime funksionale	- Udhëzime. - Urime festash. - Plane të ndryshme. - Ftesa. - Falënderime. - Njoftime. - Letra.	Nxënës/i /ja: - shkruan udhëzime, adresa, urime festash, argumente të thjeshta, ftesa, falënderime, letër ndjese, plane javore dhe njoftime; - shkruan duke respektuar strukturën e tekstit që përfshin hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen; - respekton formën ose modelin e përshtatshëm p.sh., gjatë shkrimit të një letre ose njoftimi shkruan formulimet e hapjes e të mbylljes etj.

GRAMATIKË *(Njohuritë dhe konceptet gramatikore trajtohen duke u integruar me të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit)*	
PËRMBAJTJA MËSIMORE	**REZULTATET E TË NXËNIT**
- Zgjedhimi i parë i foljeve. - Zgjedhimi i dytë i foljeve. - Zgjedhimi i tretë i foljeve. - Pjesëzat mohuese *nuk* dhe *s'*. - Emrat e përveçëm dhe të përgjithshëm. - Përdorimi i shkronjës së madhe te emrat e përveçëm dhe në fillim të fjalisë. - Shumësi e emrave. - Lakimi i emrit në njëjës dhe në shumës, trajta e pashquar dhe trajta e shquar. - Mbiemrat e nyjshëm dhe të	Nxënës/i /ja: - dallon dhe përdor në fjali foljet e zgjedhimit të parë; - dallon dhe përdor në fjali foljet e zgjedhimit të dytë; - dallon dhe përdor në fjali foljet e zgjedhimit të tretë; - përdor në fjali pjesëzat mohuese *s* dhe *nuk*; - përcakton nëse emri është i përgjithshëm ose i përveçëm; - argumenton pse një emër është i përgjithshëm ose i përveçëm; - përdor drejt shkronjën e madhe tek emrat e përveçëm dhe në fillim të fjalisë; - dallon emrat në numrin shumës; - lakon emrat në trajtën e shquar dhe të pashquar; - dallon mbiemrat e nyjshëm dhe të panyjshëm;

panyjshëm. - Lakimi i mbiemrave. - Ndajfoljet e mënyrës (*mirë, keq).* - Shkallët e mbiemrit dhe të ndajfoljes. - Koha e tashme, forma joveprore. - Përemrat pronorë. - Koha e pakryer dhe koha e kryer e thjeshtë e foljeve *kam* dhe *jam*. - Koha e ardhme e foljeve *kam* dhe *jam.* - Koha e tashme dhe koha e ardhme e mënyrës lidhore. - Koha e pakryer e mënyrës dëftore dhe koha e pakryer e mënyrës lidhore (forma veprore). - Koha e pakryer e mënyrës dëftore dhe koha e pakryer e mënyrës lidhore (forma joveprore).	- ndërton fjali me mbiemra të nyjshëm dhe të panyjshëm; - dallon dhe përdor në fjali ndajfoljet e mënyrës; - dallon shkallët e mbiemrave dhe të ndajfoljeve; - dallon përemrat pronorë dhe i përdor ato në fjali; - zgjedhon foljet në kohën e tashme, në formën joveprore; - zgjedhon foljet *kam* dhe *jam* në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme të mënyrës dëftore; - zgjedhon foljet në kohën e tashme dhe kohën e ardhme të mënyrës lidhore; - zgjedhon foljet në kohën e pakryer të mënyrës dëftore dhe në kohën e pakryer të mënyrës lidhore (forma veprore); - zgjedhon foljet në kohën e pakryer e mënyrës dëftore dhe në kohën e pakryer të mënyrës lidhore (forma joveprore).

HISTORI

TEMATIKA	PËRMBAJTJA MËSIMORE	REZULTATET E TË NXËNIT
IDENTITETI IM	- Populli shqiptar, origjina, shtrirja gjeografike. - Shqiptarët në lashtësi. - Shqiptarët si pjesë e Ballkanit dhe e Evropës. (*Cili është populli im? Ku jeton ai?)*	Nxënës/i /ja: - përshkruan origjinën dhe shtrirjen gjeografike të popullit shqiptar duke shfrytëzuar burime të ndryshme informacioni; - paraqet të dhëna që dëshmojnë për shqiptarët, si një ndër popujt më të vjetër të Ballkanit dhe të Evropës; - përshkruan, referuar burimeve, marrëdhëniet e shqiptarëve me fqinjët dhe me popujt e tjerë të Evropës.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	- Paraardhësit tanë: ilirët, shtrirja e tyre dhe fiset kryesore. - Aspekte të jetës në Iliri. - Mesjeta, nga arbrit tek shqiptarët. - Figura të historisë kombëtare dhe më gjerë:	Nxënës/i /ja: - përcakton shtrirjen në kohë të fiseve ilire; - rendit argumente që dëshmojnë vazhdimësinë historike ilire-arbërore-shqiptare; - shqyrton dhe familjarizohet me burime nga kjo periudhë kohore;

	mbretërit ilirë Bardhyli, Genti, Longari, Agroni, Teuta; Skënderbeu, Ali Pashë Tepelena, Ismail Qemali, Ahmet Zogu, Shën Nëna Tereze dhe të tjerë të kohës moderne.	- përshkruan aspekte të jetës së ilirëve si: shtëpitë, veshjet, bujqësinë, ushqimin dhe gatimin, teknologjinë që zhvillonin dhe përdoreshin në lashtësi, punët që kryenin, veglat dhe armët, gjuha, kultura, arti dhe muzika, argëtimi dhe koha e lirë, tregime për njerëzit e kësaj periudhe; - tregon për mënyrën e jetesës së popullit tonë në Mesjetë; - krijon muzeun virtual për historinë e vendit të prejardhjes; - përshkruan veprën e disa prej personaliteteve që kanë lënë gjurmë në zhvillimin historik, kombëtar, kulturor dhe shoqëror të shqiptarëve; - vlerëson kontributin dhe veprimtarinë e shqiptarëve.
KULTURA DHE SHOQËRIA	- Tradita e popullit tim. - Simbolet kombëtare. - Festat kombëtare dhe fetare. - Shkrimet e para shqipe.	Nxënës/i /ja: - dallon traditat popullore të kombit shqiptar si: gjuha, veshja, lojërat, folklori, muzika etj.; - dallon simbolet kombëtare dhe i rendit ato në mënyrë kronologjike duke përshkruar origjinën e tyre; - përshkruan origjinën e festave kombëtare në vendin tonë; - mbledh fotografi dhe krijon album me veshje popullore, vegla popullore për vendin e prejardhjes; - përcakton në rend kronologjik shkrimet e para shqipe dhe autorët e tyre; - vlerëson rëndësinë e festave kombëtare dhe përshkruan mënyrën e festimit të tyre.
NJË BOTË PËR TË GJITHË	- Bota - familje e madhe ku jam pjesëtar edhe unë. - Të drejtat dhe detyrimet universale të njerëzimit.	Nxënës/i /ja: - vlerëson dhe respekton origjinën, traditat dhe besimet e ndryshme të shokëve të shkollës; - identifikon karakteristikat dalluese të popujve të ndryshëm, si: raca, origjina, feja, gjuha, kultura etj.; - vlerëson dhe respekton të drejtat dhe detyrimet që vlejnë për të gjithë njerëzit, pavarësisht prejardhjes; - dallon ndërvarësinë e njerëzve në komunitet, në shtet, në Evropë dhe në botë; - vlerëson identitetin kombëtar, identitetin evropian dhe atë si qytetar i

		botës.
MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË	- Si arsimohej populli ynë gjatë shekujve? - Si janë argëtuar të parët tanë?	Nxënës/i /ja: - dallon momentet më të rëndësishme të ecurisë së arsimit shqip gjatë shekujve (që nga antika, mesjeta e deri në ditët e sotme); - dallon aktivitetet e kohës së lirë në periudha të ndryshme të historisë së popullit shqiptar.

GJEOGRAFI

TEMATIKAT	PËRMBAJTJET MËSIMORE	REZULTATET E TË NXËNIT
IDENTITETI IM	- Veçoritë gjeografike të vendeve dhe të rajoneve në vendin e prejardhjes dhe në vendin ku jetojnë.	Nxënës/i /ja: - krahason veçoritë gjeografike (relievi, klima, ujërat, bota bimore e shtazore) të vendit të prejardhjes me ato të vendit ku jeton; - gjen në hartë format kryesore të relievit, detet, lumenjtë, liqenet, vendbanimet e vjetra dhe trajtat unikale (bifurkacionin e Nerodimës).
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	- Migrimi, shkaqet dhe pasojat. - Vendbanimet dhe arkitektura tradicionale dhe bashkëkohore. - Veçoritë e përgjithshme të zhvillimit ekonomik të vendit të prejardhjes dhe atij të banimit.	Nxënës/i /ja: - përshkruan shkaqet kryesore të lëvizjeve migruese; - identifikon pasojat e lëvizjeve migruese; - dallon të përbashkëtat dhe të veçantat e vendbanimeve dhe të arkitekturës së vendit të prejardhjes dhe të vendit të banimit; - krahason veprimtaritë ekonomike të vendit të prejardhjes me ato të vendit ku jeton.
KULTURA DHE SHOQËRIA	- Identiteti kulturor i vendit të prejardhjes në kushtet e globalizmit. - Dallimet në gjuhë, besim e kulturë të popujve në vendin e prejardhjes dhe të banimit.	Nxënës/i /ja: - përshkruan disa ndër vlerat historiko-kulturore të vendit të prejardhjes dhe vendit ku jeton (veçoritë dalluese në gjuhë, doke, zakone, në besim, tolerancë fetare, marrëdhënie ndëretnike etj.).
NJË BOTË PËR TË GJITHË	- Kujdesi dhe mbrojtja e mjedisit. - Bukuritë e Atdheut. Si t`i shijojmë dhe si t`ua prezantojmë të tjerëve?	Nxënës/i /ja: - përshkruan ndikimin e njeriut në mjedisin natyror dhe anasjelltas, ndikimin e mjedisit natyror në veprimtarinë e njeriut; - identifikon dhe përshkruan disa nga bukuritë natyrore të atdheut;

		- bën krahasime midis bukurive natyrore të vendit ku jeton me ato në Atdhe dhe shpjegon se si prezantohen ato për turistët.
MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË	- Veçoritë ekonomike e shoqërore të Atdheut. - Vizita në parqet, kopshtet botanike e zoologjike.	Nxënës/i /ja: - krahason veprimtaritë ekonomike të vendit të prejardhjes, duke i krahasuar me ato të vendit ku jeton; - njeh dhe krahason parqet, kopshtet botanike e zoologjike në vendin ku jeton dhe në Atdhe.

KULTURË FIGURATIVE

TEMATIKA	**PËRMBAJTJA MËSIMORE**	**REZULTATET E TË NXËNIT**
IDENTITETI IM	- Rrënjët e mia dhe të familjes sime. - Fotografitë e familjes sime. - Banesa karakteristike shqiptare (kulla/ banesa qytetare). - Peizazhe nga natyra shqiptare.	Nxënës/i /ja: - vizaton portrete të anëtarëve të familjes duke i veshur me veshjen karakteristike të vendit të origjinës; - krijon album me fotografi të vjetra nga rrethi familjar; - njeh llojet e ndërtimeve arkitekturore qytetare e fshatare shqiptare; - vizaton monumente të trashëgimisë kulturore në arkitekturë, si: një kështjellë, urë, banesë karakteristike (kulla/banesa qytetare); - pikturon, vizaton ose krijon albume nga pamje me motive të ambientit familjar dhe nga jeta në vendin e prejardhjes; - krijon mbi këto tema në mënyrë të pavarur dhe duke përdorur mjete e teknika te ndryshme.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	- Motive të veshjeve shqiptare. - Mjedisi dhe peizazhi shqiptar. - Butrinti (një shembull i të shkruarës **s**ë popullit tim)**.** - Heroi ynë kombëtar, Skënderbeu. - Vepra të krijuesve shqiptarë.	Nxënës/i /ja: - kërkon në internet veshje tipike popullore shqiptare sipas krahinave dhe krijon album me to; - vizaton një dekoracion me motive të marra nga veshjet apo qilimat popullorë në krahina të ndryshme shqiptare; - krijon një album fotografik me pamje nga natyra shqiptare; - zbulon periudhat e zhvillimit historik të qytetit antik të Butrintit nëpërmjet ndërtimeve të zbuluara nga gërmimet arkeologjike; - pikturon ose modelon sipas interesave dhe aftësive individuale, një portret ose kompozim kushtuar heroit kombëtar, Skënderbeu; - njeh vepra dhe autorë të ndryshëm shqiptarë gjatë shekujve, si: Onufri, Odhise Paskali, Zef

		Shoshi, Abdurrahim Buza, Ibrahim Kodra etj.; - krijon mbi këto tema në mënyrë të pavarur dhe duke përdorur mjete e teknika të ndryshme.
KULTURA DHE SHOQËRIA	- Shën Nëna Tereze-krenaria jonë (portret). - Figura e njohur e legjendës shqiptare, Gjergj Elez Alia. - Flamuj dhe shtete, ngjyra dhe simbole. - Objekte të trashëgimisë kulturore. - Logo/emblema - ekipi kombëtar shqiptar.	Nxënës/i /ja: - pikturon ose modelon sipas interesave dhe aftësive individuale një portret apo kompozim kushtuar Shën Nënës Tereze; - kompozon sipas imagjinatës, me mjete e teknika të ndryshme figurën e Gjergj Elez Alisë; - zbulon vlerat estetike të objekteve të trashëgimisë kulturore (objekte të përdorimit të përditshëm si: enë qeramike, lugë të gdhendura, karrige të gdhendura etj.); - realizon një objekt të përdorimit të përditshëm, në vizatim ose me mjete tredimensionale duke u mbështetur në karakteristikat e objekteve të trashëgimisë kulturore; - realizon *logo* ose *emblema* për një qëllim të caktuar (*për ekipin kombëtar shqiptar apo për një produkt shqiptar*), duke përdorur simbole të njohura të identitetit kombëtar; - krijon mbi këto tema në mënyrë të pavarur dhe duke përdorur mjete e teknika të ndryshme.
NJË BOTË PËR TË GJITHË	- Mjedisi i pastër dhe shëndeti ynë. - Jeta e lumtur në planetin tonë.	Nxënës/i /ja: - krijon mbi këto tema në mënyrë të pavarur dhe duke përdorur mjete e teknika të ndryshme.
MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË	- Vepra të krijuesve shqiptarë. - Vizitë në galeri, muze arti apo në atelie të ndonjë krijuesi. - Dhuratë mikut (*mozaik me materiale të kombinuara e me motive shqiptare*).	Nxënës/i /ja: - përshkruan dhe komenton krijimtarinë figurative të emrave të njohur shqiptarë dhe e krahason atë me krijuesit e vendit ku jeton; - shprehet në mënyrë krijuese në teknikat e zgjedhura për punimet me temë të caktuar.

KULTURË MUZIKORE

TEMATIKA	**PËRMBAJTJA MËSIMORE**	**REZULTATET E TË NXËNIT**
IDENTITETI IM	- Këngët e popullit tim, nga treva të ndryshme. Karakteristika të ritmeve muzikore.	Nxënës/i /ja: - dallon ritmet muzikore popullore shqiptare përmes dëgjimeve të këngëve popullore;

	- Kënga e kultivuar popullore shqiptare sipas trevave të ndryshme. - Kënga patriotike.	- evidenton dhe imiton elementet që e shquajnë muzikën popullore (*ritmet, meloditë*); - këndon këngë popullore dhe të kultivuara nga treva të ndryshme shqiptare; - njeh disa nga veprat më të shquara të muzikës artistike shqiptare patriotike; - këndon këngë patriotike shqiptare.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	- Krijues dhe interpretues të shquar të muzikës popullore shqiptare. - Krijues dhe interpretues të shquar të muzikës artistike shqiptare.	Nxënës/i /ja: - njeh disa prej krijuesve dhe interpretuesve të shquar të muzikës popullore shqiptare; - njeh disa prej krijuesve dhe interpretuesve të shquar të muzikës së kultivuar shqiptare; - dëgjon duke përjetuar vepra të krijuesve muzikorë shqiptarë; - mban qëndrim ndaj muzikës që dëgjon, duke dhënë opinionin e vet.
KULTURA DHE SHOQËRIA	- Folklori muzikor shqiptar (*vokal dhe instrumental*). - Instrumentet popullore: *çiftelia, sharkia, fyelli, dajrja (defi), daullja e madhe (tupani)* etj. - Kënga dhe vallja popullore nga treva të ndryshme shqiptare.	Nxënës/i /ja: - kupton rëndësinë e ruajtjes dhe të transmetimit të folklorit shqiptar (*muzikor, koreografik, instrumental, vokal*); - dallon disa nga instrumentet e muzikës popullore shqiptare; - njeh disa nga vallet më të njohura shqiptare; - interpreton folklorin e krahinës së prejardhjes së tij/saj.
NJË BOTË PËR TË GJITHË	- Muzika si gjuhë universale e popujve.	Nxënës/i /ja: - argumenton se muzika është e shumëllojshme, por e kuptueshme nga të gjithë popujt pavarësisht gjuhës që flasin; - shpjegon se muzika është mjet komunikimi ndërmjet njerëzve.
MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË	- Muzika në shkollë. - Muzika në familje. - Muzika për kohën e lirë.	Nxënës/i /ja: - njeh dhe dallon muzikën me vlerë edukative, që mësohet në shkollë, nga ajo me karakter argëtues e zbavitës, që dëgjon në kohën e lirë; - interpreton ndonjërën nga këngët e mësuara; - shprehet me gojë ose me shkrim mbi muzikën që dëgjohet ose kultivohet në familjen e tij.

NIVELI I TRETË

GJUHË SHQIPE

(*Përdorues kompetent i gjuhës*)

TË DËGJUARIT		
PËRMBAJTJA MËSIMORE		**REZULTATET E TË NXËNIT**
Të dëgjuarit për të kuptuar	- Dëgjimi i rrëfimeve personale, i bisedave dhe i diskutimeve për tema që kanë lidhje me jetën e përditshme (*shkolla, mësimi, koha e lirë, argëtimi, mjedisi, të drejtat dhe përgjegjësitë individuale dhe përgjegjësitë në grup*. - Kuptimi dhe analiza e informacioneve të marra nga burime të ndryshme	Nxënës/i /ja: - ndjek lehtësisht dhe merr pjesë në bashkëbisedime, diskutime dhe debate për çështje të ndryshme; - kujton njohuritë paraprake që ka rreth temës ose rreth përmbajtjes së tekstit; - parashikon për tekstin që po dëgjon; - pyet ose kërkon sqarime për idetë, konceptet ose fjalët që nuk i kupton mirë; - kërkon informacion shtesë për atë që dëgjon; - tregon me detaje dhe ilustrime përmbajtjen ose brendinë e tekstit; - interpreton tekstin duke dhënë gjykimet e tij.
Të dëgjuarit e qëllimshëm	- Dëgjimi i qëllimshëm i teksteve për të përcaktuar ngjashmëri dhe dallime mes tyre, për të dalluar rendin e ngjarjeve, problemin dhe zgjidhjen e tij, shkakun dhe pasojën, si dhe synimin e folësit.	Nxënës/i /ja: - identifikon ngjashmëri dhe dallime mes informacioneve që dëgjon nga burime të ndryshme (*në biseda, në televizion ose në ndonjë media tjetë*r); - dallon rendin e ngjarjeve dhe të ideve; - klasifikon detajet dhe përcakton problemin kryesor dhe zgjidhjen në një tekst; - dallon shkakun dhe pasojën në një tekst; - përcakton qëllimin ose synimin e folësit (*këshillon, bind, sqaron etj.).*
Të dëgjuarit e teksteve letrare dhe jo letrare	- Tekste jo letrare si artikuj gazetash dhe revistash, reportazhe, intervista, anketa në televizion etj. - Tekste letrare të gjinive dhe të llojeve të ndryshme nga autorë/e përfaqësues/e të letërsisë shqiptare.	Nxënës/i /ja: - dallon informacione specifike nga njoftime, udhëzime, fjalime, rrëfime etj.; - përcakton tiparet kryesore të teksteve letrare si përralla, legjenda, tregimi, poezia etj.; - dallon lidhjen që ka letërsia me artin figurativ, muzikën, teatrin, kinematografinë etj.

TË FOLURIT		
PËRMBAJTJA MËSIMORE		**REZULTATET E TË NXËNIT**
Organizimi i të folurit	- Rrëfime, përshkrime dhe udhëzime të ndryshme rreth	Nxënës/i /ja: - flet qartë dhe rrjedhshëm, me strukturë logjike dhe duke përdorur fjalorin e duhur;

	prejardhjes, vendlindjes dhe atdheut. - Prezantimi i atdheut të prejardhjes në kohë dhe në hapësirë si dhe i simboleve kombëtare e shtetërore.	- përshtat të folurit në varësi të tematikës, dëgjuesit, qëllimit dhe situatës; - përshkruan qartë dhe në detaje, duke zhvilluar çështje të rëndësishme dhe duke nxjerrë përfundime; - rrëfen ngjarje të ndryshme me gjuhë shprehëse; - përmbledh ngjarjet kryesore të tregimeve të ndryshme; - jep udhëzime të qarta për çështje të ndryshme; - përdor gjuhën standarde shqipe në situata formale dhe joformale; - zgjedh fjalët dhe frazat e duhura për të tërhequr vëmendjen e dëgjuesit; - përgatit prezantime duke përdorur edhe teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit.
Bashkëveprimi dhe diskutimi në grup	- Biseda, diskutime dhe debate që zhvillohen në grup për tema të caktuara që kanë interes për nxënës/it/et. - Diskutime dhe debate rreth problemeve të shoqërisë bashkëkohore. - Komunikimi në distancë (*telefon, internet dhe forma tjera).*	Nxënës/i /ja: - bisedon qartë, qetësisht dhe rrjedhshëm me të tjerët; - pyet për t'u sqaruar dhe për të marrë më shumë informacion gjatë diskutimeve në grup; - ofron të dhëna ose informacion si dhe shpreh mendimin ose këndvështrimin e tij/saj personal; - mbron argumentet e tij/saj gjatë diskutimeve në grup, si dhe pranon mendimet dhe idetë e të tjerëve; - reciton me ndjenjë pjesë të ndryshme para bashkëmoshatarëve dhe mësuesve në aktivitete të ndryshme; - planifikon dhe organizon lojëra me role dhe dramatizime me shokët dhe shoqet e klasës.

TË LEXUARIT		
PËRMBAJTJA MËSIMORE		**REZULTATET E TË NXËNIT**
Të lexuarit për të kuptuar	- Tekste që pasqyrojnë kulturën, traditat, historinë dhe bukuritë natyrore të trevave shqiptare.	Nxënës/i /ja: - lexon pjesë-pjesë tekstin dhe parashikon se çfarë do të ndodhë më pas duke dhënë arsyetime dhe argumente për parashikimin e tij; - përmbledh idetë kryesore duke i ilustruar me shembuj dhe detaje nga teksti; - u përgjigjet pyetjeve për përmbajtjen e tekstit; - lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën ose leximet e mëparshme; - krahason në një tekst dy ose më shumë ide, koncepte, detaje, personazhe etj.; - gjykon me argumente idetë dhe informacionin e tekstit; - interpreton idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë

		ose të nënkuptuar në tekst.
Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare	- Tekste të letërsisë gojore si: përrallat, këngët e kreshnikëve, legjendat, këngët lirike popullore etj. - Dokumentet e para të shkrimit shqip. - Lashtësia e gjuhës shqipe. - Autorë dhe vepra të letërsisë shqipe sipas zhvillimit të saj në kohë dhe në hapësirë: poezi, prozë, dramë (*lloje të ndryshme*). - Tekste jo letrare si: autobiografi, biografi, intervista, udhëzime, rregullore, artikuj gazetash dhe revistash, njoftime, letra etj.	Nxënës/i /ja: - lexon tekste të ndryshme letrare poetike në prozë dhe dramatike (*të përshtatshme për moshën e tij*); - diskuton rreth përmbajtjes, personazheve, përshtypjeve dhe ndjesive për tekstet që lexon; - tregon përmbajtjen duke u bazuar në fjalët kyç, skicat ose fotot e figurat; - bën pyetje të ndryshme rreth tekstit; - u përgjigjet pyetjeve rreth tekstit me fjalët e tij/saj ose me shembuj nga teksti; - rendit ngjarjet e një teksti; - përshkruan kohën dhe mjedisin ku ndodhin ngjarjet; - përshkruan pamjen e jashtme, tiparet, sjelljen e personazheve (*duke u bazuar në tekst*); - gjen në një tekst idetë kryesore dhe formulon temën dhe idenë kryesore; - kërkon informacion për fjalët e panjohura dhe mëson t'i përdorë ato; - përdor bibliotekën dhe internetin për të lexuar tekste të ndryshme. **Të lexuarit e teksteve jo letrare** Nxënës/i /ja: - lexon tekste nga kultura dhe periudha të ndryshme, elektronike dhe të shtypura si: autobiografi, biografi (*të një shkrimtari, sportisti, shkencëtari etj.),* intervista, enciklopedi të shtypura dhe elektronike, udhëzime, rregullore, artikuj gazetash dhe revistash, njoftime; - pasuron fjalorin me fjalë dhe terminologji nga fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore (*nga tekstet që lexon*) dhe i përdor ato; - ndan përvojat dhe kënaqësitë e leximit me shokët e shoqet; - dallon shkakun dhe pasojën në një tekst; - dallon problemin dhe zgjidhjen në një tekst; - dallon në një tekst përdorimin e argumenteve *për* dhe *kundër* për një çështje të caktuar; - shpjegon funksionin e grafikëve, tabelave, pikturave, ilustrimeve me të cilat shoqërohen tekstet.

TË SHKRUARIT		
PËRMBAJTJA MËSIMORE		**REZULTATET E TË NXËNIT**
Të shkruarit për qëllime personale	- Poezi të thjeshta. - Tregime të shkurtra duke iu përmbajtur disa elementeve si: *personazh, dialog, fabul, mjedis, kohë.*	Nxënës/i /ja: - shpreh me vargje të thjeshta ndjenjat dhe mendimet e tij; - shkruan tregime të shkurtra duke iu përmbajtur disa elementeve si: *personazh, dialog, fabul, mjedis, kohë*;

	- Shkrime përmbajtjesh të librave. - Përshkrime personazhesh. - Përshkrime të ndjenjave dhe përjetimeve personale.	- kthen një tekst poetik në prozë; - rrëfen brendinë e një libri të preferuar për të; - përshkruan personazhet duke pasqyruar ndjenjat dhe mendimet, paraqitjen e jashtme dhe veprimet e tij; - shkruan për ndjenjat dhe për përjetimet që i ngjall një tekst letrar si: tregim, poezi, përrallë etj.; - përdor gjuhën standarde dhe fjalor të pasur gjatë të shkruarit.
Të shkruarit për qëllime funksionale	- Shpjegime. - Udhëzime. - Njoftime. - Letra formale. - Intervista drejtuar një personi të dashur ose të pëlqyeshëm nga fusha e artit, sportit, kinematografisë etj. - Ese të ndryshme.	Nxënës/i /ja: - shkruan shpjegime, udhëzime, njoftime etj.; - shkruan letra formale; - shkruan një intervistë drejtuar një personi të dashur ose të pëlqyeshëm për ta nga fusha e artit, sportit, kinematografisë; - respekton formën ose modelin e përshtatshëm gjatë të shkruarit; - shkruan ese.

GRAMATIKË *(Njohuritë dhe konceptet gramatikore trajtohen duke u integruar me të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit)*	
PËRMBAJTJA MËSIMORE	**REZULTATET E TË NXËNIT**
- Përemrat lidhorë. - Lakimi i përemrave vetorë. - Trajtat e shkurtra të përemrave vetorë. Përdorimi i trajtave të shkurtra. - Lakimi i përemrave pronorë. - Foljet e rregullta dhe foljet e parregullta. - Përshtatja e foljes me emrin kryefjalë. - Koha e kryer, koha më se e kryer, koha e kryer e tejshkuar e mënyrës dëftore - Pjesorja. - Mënyra dëshirore. - Mënyra kushtore. - Mënyra habitore. - Format e pashtjelluara të foljes; pjesorja, përcjellorja dhe paskajorja. - Rendi i përcaktorëve në një fjali. - Rendi i fjalëve në gjuhën shqipe.	Nxënës/i /ja: - dallon dhe përdor në fjali përemrat lidhorë; - ndërton fjali të përbëra me përemra lidhorë; - lakon përemrat vetorë; - dallon dhe përdor si duhet trajtat e shkurtra të përemrave vetorë; - dallon foljet e rregullta nga foljet e parregullta; - zgjedhon disa folje të parregullta; - përshtat në fjali foljen me emrin kryefjalë; - zgjedhon foljet në kohën e kryer, kohën më se të kryer, koha e kryer të tejshkuar të mënyrës dëftore; - dallon pjesore në fjali të ndryshme; - zgjedhon foljet në mënyrën dëshirore; - ndërton fjali me foljet në mënyrën dëshirore; - zgjedhon foljet në mënyrën kushtore; - ndërton fjali me foljet në mënyrën kushtore; - zgjedhon foljet në mënyrën habitore; - ndërton fjali me foljet në mënyrën habitore; - zgjedhon foljet në mënyrën urdhërore; - ndërton fjali me foljet në mënyrën urdhërore; - dallon format e pashtjelluara të foljes; - formon fjali duke i renditur si duhet përcaktorët në një fjali; - njeh dhe përdor si duhet rendin e fjalëve në gjuhën shqipe.

HISTORI

TEMATIKA	PËRMBAJTJA MËSIMORE	REZULTATET E TË NXËNIT
IDENTITETI IM	- Origjina e popullit shqiptar. - Vendi i të parëve tanë. - Vendet ku jetojnë sot shqiptarët. - Identiteti evropian i shqiptarëve.	Nxënës/i/ja: - argumenton origjinën e ilirëve, arbërve dhe shqiptarëve, duke vlerësuar përpjekjet për identitet kombëtar; - krahason dhe vlerëson në mënyrë kritike pikëpamjet e ndryshme mbi këtë çështje mbështetur në burime; - identifikon hapësirat gjeografike ku jetojnë sot shqiptarët; - argumenton mbështetur në burime identitetin evropian të shqiptarëve.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	- Historia e qendrave të qytetërimit të lashtë shqiptar: Lipjani (Ulpiana), Shkupi (Skupi), Shkodra (Scodra), Durrësi (Dyrrah), Lezha (Lissus), Apolonia, Butrinti, Ulqini etj. - Gjetjet arkeologjike dhe faktet historike që vërtetojnë lashtësinë e shqiptarëve. - Organizimi shtetëror i shqiptarëve. - Shteti i Arbrit në Mesjetë. - Shqiptarët gjatë periudhës së Skënderbeut. - Tiparet themelore të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. - Shqiptarët gjatë shekullit XX. - Lufta e shqiptarëve për liri, pavarësi, barazi (në të gjitha trevat) dhe emancipim kombëtar. - Emigrimet shqiptare gjatë historisë dhe ndihmesa e shqiptarëve të diasporës për Atdheun. - Personalitete historike dhe bashkëkohore iliro-shqiptare në zë për njerëzimin. *(Prej shenjtëve Jeronimi, Flori dhe Lauri, Skënderbeu e deri te Shën Nëna Tereze);*	Nxënës/i/ja: - përcakton në hartë qendrat kryesore historike të lashtësisë shqiptare; - përshkruan karakteristikat e tyre historike; - identifikon fakte historike-arkeologjike që flasin për lashtësinë e shqiptarëve; - vendos në linjën e kohës ngjarjet më të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar; - shpjegon ngjarjet kryesore historike të popullit shqiptar nga Mesjeta deri më sot; - paraqet organizimin e shtetit shqiptar dhe tiparet e tij nga arbrit te Skënderbeu; - evidenton aftësinë shtetformuese të shqiptarëve që nga mbretëritë e para ilire deri te shteti i pavarur i Kosovës; - vlerëson përpjekjet dhe luftën e shqiptarëve për arsim kombëtar dhe pavarësi; - mbledh dëshmi (*objekte, fotografi, dokumente të shkruara*) dhe shpjegon nëpërmjet tyre mënyrën e jetesës së popullit shqiptar në periudha të ndryshme historike; - përcakton periudhat historike të emigrimeve të shqiptarëve; - tregon rolin që ka luajtur dhe luan diaspora shqiptare në kultivimin e kulturës kombëtare dhe ruajtjen e identitetit tonë kombëtar;

		- vlerëson rolin dhe kontributin e çmuar që ka dhënë emigracioni shqiptar për vendlindjen; - vlerëson kontributin dhe veprimtarinë e disa prej personaliteteve që kanë lënë gjurmë në zhvillimin historik, kombëtar, kulturor dhe social të shqiptarëve.
KULTURA DHE SHOQËRIA	- Monumentet kryesore historike të Atdheut tim. *(Monumentet arkeologjike, kultura materiale dhe shpirtërore).* - Gjuha shqipe ndër gjuhët më të vjetra të Ballkanit dhe Evropës, gjuhë indoevropiane. - Mjekësia popullore shqiptare gjatë historisë. - Kanunet shqiptare dhe kodikët (*Kanuni i Skënderbeut, Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kodikët e Beratit etj.).* - Bashkëjetesa paqësore fetare e shqiptarëve-shembull për respekt, tolerancë dhe begati shpirtërore e kulturore. - Organizimi i jetës në të kaluarën dhe sot. - Historia e arsimit dhe shkollës shqipe. Personalitete të shquara të arsimit kombëtar (*nga e kaluara deri më so*t). - Sportistë, artistë dhe shkencëtarë të shquar shqiptarë.	Nxënës/i/ja: - përcakton vendndodhjen e monumenteve kryesore arkeologjike në atdhe; - vlerëson kulturën materiale dhe shpirtërore të shqiptarëve dhe rëndësinë e monumenteve kulturore dhe historike; - dallon historikun e zhvillimit të gjuhës shqipe dhe të gjuhës së vendit ku jeton; - vlerëson rolin dhe rëndësinë e mjekësisë popullore shqiptare në të kaluarën dhe sot; - diskuton dhe vlerëson për organizimin kanunor te shqiptarëve; - dallon karakteristikat kryesore të besimeve fetare të shqiptareve dhe çmon tolerancën fetare si një vlerë kombëtare; - krahason në të shkuarën dhe të sotmen stilet dhe mënyrat e jetesës së vendit të tij/saj të prejardhjes me vendin ku jeton tani, si dhe tregon dallimet dhe ngjashmëritë; - analizon dhe vlerëson etapat dhe ecuritë e arsimit kombëtar shqiptar; - vlerëson veprimtarinë dhe kontributin e figurave më të shquara të arsimit kombëtar që nga lashtësia deri më sot; - njeh dhe vlerëson veprimtarinë e disa prej sportistëve, artistëve dhe shkencëtarëve të shquar shqiptarë që kanë lënë gjurmë në artin, kulturën, shkencën dhe sportin botëror.

NJË BOTË PËR TË GJITHË	- Kontributi i shqiptarëve për bashkëpunim dhe integrim në botë. - Qytetërimi ilir dhe kontributi tij në kulturën e lashtë evropiane. - Skënderbeu dhe roli i tij si mbrojtës i qytetërimit evropian. - Shën Nëna Tereze si model i humanizmit njerëzor botëror.	Nxënës/i/ja: - argumenton kontributin e shqiptarëve për integrim në nivel ndërkombëtar; - vlerëson dhe respekton larminë në shoqërinë ku jeton, si dhe kontributin e kulturave dhe të grupeve të ndryshme fetare e shoqërore; - vlerëson trashëgiminë e përbashkët historike e kulturore të popujve në ndërtimin e Evropës së bashkuar; - vlerëson rolin dhe kontributin e personaliteteve të kombit shqiptar, në fusha të ndryshme të kulturës, politikës, arsimit, shkencës, mjekësisë dhe qytetërimit botëror, në përgjithësi.
MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË	- Etapat kryesore të arsimit dhe të shkollës shqipe. - Personalitetet e shquara të arsimit kombëtar. - Organizimi i jetës në të kaluarën dhe sot.	Nxënës/i/ja: - analizon dhe vlerëson etapat dhe ecuritë e arsimit kombëtar shqiptar; - dallon, njeh dhe përshkruan veprimtaritë e figurave më të shquara të arsimit kombëtar që nga lashtësia deri më sot; - kupton dhe bën krahasime mes stileve dhe mënyrave të jetesës, dikur dhe tani.

GJEOGRAFI

TEMATIKAT	PËRMBAJTJET MËSIMORE	REZULTATET E TË NXËNIT
IDENTITETI IM	- Pozita gjeografike e vendit të prejardhjes së të parëve në nivel rajonal, evropian e botëror. - Bukuritë e natyrës shqiptare. - Pasuritë nëntokësore shqiptare.	Nxënës/i/ja: - analizon rëndësinë e pozitës së vendit të prejardhjes së të parëve (*Atdheut)* në nivel rajonal, evropian e botëror; - evidenton bukuritë e natyrës shqiptare (Alpet Shqiptare, Vargu i Korabit, Bjeshkët e Nemuna, Brezovica, Malet e Sharrit, bifurkacioni i Nerodimës, Ujëvarat e Mirushes, Gryka e Rugovës, Deti Adriatik, Deti Jon, Butrinti, Artana (Novo Bërda), Liqenet e Lurës, Liqeni i Shkodrës, Liqeni i Ohrit, Liqeni i Prespës etj.); - ndërton një hartë fizike-gjeografike të vendit të prejardhjes (*ose plotëson hartën fizike të vendit të prejardhjes*) me format e relievit, lumenjtë, liqenet, pasuritë nëntokësore dhe qendrat kryesore të banimit.

SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	- Migrimi i shqiptarëve. - Kontributi i emigrantëve ne zhvillimin e vendit të prejardhjes. - Vendbanimet dhe karakteristikat e tyre. - Zhvillimi ekonomik i vendit të prejardhjes. - Ngjashmëritë dhe dallimet ekonomike e shoqërore të vendit të prejardhjes në raport me rajonin, Evropën dhe zhvillimet globale. - Turizmi shqiptar.	Nxënës/i/ja: - përshkruan historikun e migrimit të popullsisë shqiptare, duke u ndalur në shkaqet dhe pasojat e tij; - ndërton grafikë dhe diagrame duke shfrytëzuar të dhëna statistikore për numrin e popullsisë, shtimin natyror, strukturën gjinore, moshore, etj.; - evidenton territoret ku kanë emigruar shqiptarët me veçoritë dhe problemet e integrimit të tyre; - vlerëson kontributin e emigrantëve në zhvillimin e vendit të prejardhjes; - dallon llojet e vendbanimeve dhe krahason arkitekturën e tyre në raport me vendin ku jeton; - njeh dhe krahason ngjashmëritë dhe ndryshimet në zhvillimet ekonomike të vendit të prejardhjes dhe vendit të banimit; - vlerëson rëndësinë e pasurive natyrore dhe kulturore të vendit të prejardhjes për zhvillimin turistik të tyre; - identifikon disa ndër pikat turistike të vendit të prejardhjes; - përshkruan çfarë ofrojnë këto vende për turistët.
KULTURA DHE SHOQËRIA	- Mjedisi dhe peizazhi shqiptar. - Parqet, kopshtet botanike e zoologjike. - Kujdesi dhe mbrojtja e mjedisit.	Nxënës/i/ja: - dallon nga fotot dhe pikturat monumente të natyrës shqiptare dhe parqe të mbrojtura me ligj nga shteti shqiptar dhe organizma ndërkombëtarë; - përshkruan ndikimin e njeriut në mjedisin natyror dhe anasjelltas, ndikimin e mjedisit natyror në veprimtarinë e njeriut.
NJË BOTË PËR TË GJITHË	- Vendi i prejardhjes (*Atdheu)*, pjesë e planetit Tokë dhe kujdesi im për të. - Vendi i prejardhjes si pjesë e integrimit evropian dhe botëror.	Nxënës/i/ja: - përshkruan përgjegjësitë e njerëzve dhe të institucioneve të vendit të prejardhjes (*Atdheut*) në kuadër të globalizmit; - vlerëson përmes një detyre tematike problemet aktuale dhe të ardhmen e zhvillimit të vendit të prejardhjes, duke e parë dhe trajtuar ato në kushtet e integrimit rajonal, evropian dhe botëror.
MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË	- Zhvillimi ekonomik i Atdheut. Ngja-shmëritë dhe dallimet ekonomike e sho-qërore të Atdheut, në raport me	Nxënës/i/ja: - njeh dhe krahason ngjashmëritë dhe ndryshimet në zhvillimet ekonomike të vendit të prejardhjes dhe vendit të banimit.

	rajonin, Evropën dhe zhvillimet globale.	

KULTURË FIGURATIVE

TEMATIKA	PËRMBAJTJA MËSIMORE	REZULTATET E TË NXËNIT
IDENTITETI IM	- Fëmijëria ime në Atdhe. - Portreti i malësorit shqiptar. - Mesazhe urimi shqiptare në lindje, dasma, ditëlindje, festa të ndryshme tipike *(kartolina).* - Atdheu im.	Nxënës/i/ja: - krijon album me foto nga udhëtimet që ka bërë në Atdhe, ose album me punimet e veta kushtuar Atdheut; - pikturon ose modelon në përmasa të vogla portretin e një malësori apo malësoreje shqiptare, duke e identifikuar atë me karakteristika *të krehjes* së zonës, *të plisit* (*në portretin e burrave*) apo *të shamisë* (*në portretin e grave*); - krijon kartolina urimi, duke u mbështetur në urimet karakteristike shqiptare, sipas ngjarjes; - krijon një poster me qëllim prezantimin e Atdheut në një ngjarje, si p.sh.: panaire të ndryshme, ngjarje sportive *(olimpiada apo kampionati i futbollit),* ngjarje artistike (*përfaqësime në ekspozita ndërkombëtare të artit apo festivale etj.)*; - krijon mbi këto tema në mënyrë të pavarur dhe duke përdorur mjete e teknika të ndryshme.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	- Arti figurativ shqiptar; historia, autorët dhe veprat. - Historiku i fotografisë. - Autorët shqiptarë, vepra dhe fama e tyre në botë. - Atdheu sot dhe nesër (*kompozim, vizatim, pikturë).* - Peizazhe shqiptare në veprat e artit (*bisedë dhe analizë).*	Nxënës/i/ja: - analizon krijimtarinë e autorëve shqiptarë duke veçuar veprat kryesore të tyre; - komenton pasuritë arkivore të fotografisë kombëtare, fototekën "Marubi" (Shkodër); - evidenton autorë shqiptarë dhe veprat e tyre që bënë jehonë nëpër botë si: *Ibrahim Kodra, Daut Berisha, Gjelosh Gjokaj, Ymer Shaqiri, Shefqet Emini, Shyqri Gjurkaj, Sislej Xhafa, Anri Sala, Adrian Paci, Destan Gashi etj.*; - krijon sipas imagjinatës me mjete dhe teknika të ndryshme; - zbulon natyrën e bukur shqiptare në peizazhet e artistëve të ndryshëm shqiptarë; - krijon mbi këto tema në mënyrë të pavarur dhe duke përdorur mjete e teknika te

		ndryshme.
KULTURA DHE SHOQËRIA	- Tradita dhe zakone: Shembull: "*Dasma shkodrane" e Kolë Idromenos.* - Vallja e shpatave. - Veshja popullore e krahinës sime. - Mjedisi dhe peizazhi shqiptar, *Shpella e Gadimës, Shpella e Pëllumbasit.* - Shpella me piktura të prehistorisë në Shqipëri, *Shpella e Lepenicës, Shpella e Rubikut, Shpella e Trenit* etj. - Motiv nga mjedisi i fshatit shqiptar. - Turizmi dhe bregdeti shqiptar (*peizazhe).* - Bukuritë e Atdheut tim (*posterë).*	Nxënës/i/ja: - paraqet elemente të traditës së dasmës nga vendi i prejardhjes, duke iu referuar idesë së veprës së Kolë Idromenos; - vizaton vallen e shpatave, duke përdorur teknikën e grafikës; - vizaton veshjen popullore shqiptare të krahinës së vet; - zbulon vende me atraksion turistik për nga bukuria natyrore dhe si artefakte të periudhës së parahistorisë në Atdhe; - përdor motive nga jeta dhe mjedisi i fshatit shqiptar (*kopshtet e mbjella, arat, fshatarët në arë etj.)*; - përshkruan ndikimin e njeriut në mjedisin natyror dhe anasjellas, ndikimin e mjedisit natyror në veprimtarinë e njeriut; - krijon peizazhe nga vendet më turistike të Atdheut nga jugu në veri *(malet, bregdetet, liqenet, lumenjt*ë, *pyjet etj.);* - krijon posterë me qëllim promovimin e vendeve turistike të Atdheut; - krijon mbi këto tema në mënyrë të pavarur dhe duke përdorur mjete e teknika të ndryshme.
NJË BOTË PËR TË GJITHË	- Krijime figurative me tema globale: *Arti i bashkon popujt; Një botë për të gjithë.*	Nxënës/i/ja: - prezanton ide dhe realizime figurative të bazuara në tema globale, të cilat bartin mesazhe të qarta të lidhjeve mes njerëzve; - krijon mbi këto tema në mënyrë të pavarur dhe duke përdorur mjete e teknika te ndryshme.
MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË	- Vizitë në galeri e muze arti apo në atelie krijuesi. - Veprat e krijuesve shqiptarë dhe botërorë. - Pamje e plane me motive nga Atdheu (*p.sh., modelim në përmasa të vogla /bocelë/ për një shesh të rëndësishëm në Atdhe*). - Lojërat popullore.	Nxënës/i/ja: - komenton krijimet e autorëve shqiptarë dhe atyre botërorë duke i krahasuar vlerat dhe teknikat e tyre; - shprehet në mënyrë të pavarur dhe me materiale të zgjedhura.

KULTURË MUZIKORE

TEMATIKA	PËRMBAJTJA MËSIMORE	REZULTATET E TË NXËNIT
IDENTITETI IM	- Muzika shqiptare, element dallues i identitetit kombëtar: *isopolifonia* dhe *këndimi maje krahut.* - Institucionet kulturore dhe arsimore të muzikës.	Nxënës/i/ja: - reflekton mbi rolin e muzikës si pjesë e identitetit kombëtar; - këndon këngë me iso apo maje krahut; - njeh rolin dhe rëndësinë që pati ngritja e institucioneve arsimore dhe muzikore.
SHQIPTARËT NË HAPËSIRË DHE NË KOHË	- Niket Dardani (himni "Te deum") dhe Jan Kukuzeli. - Muzika shqiptare (*këngë, melodi, valle*) kushtuar figurave të shquara shqiptare (*balada, këngët e kreshnikëve, këngët historike).*	Nxënës/i/ja: - njeh dhe diskuton për krijuesit e parë shqiptarë të muzikës në nivel botëror, nga aspekti historik; - këndon këngë kushtuar heronjve; - dëgjon vepra muzikore që u kushtohen heronjve dhe figurave të shquara shqiptare.
KULTURA DHE SHOQËRIA	- Muzika shqiptare: opera shqiptare, baleti shqiptar, muzika e filmit shqiptar. - Festivali Kombëtar i Gjirokastrës. - Festivalet e muzikës shqiptare dhe ngjarjet muzikore.	Nxënës/i/ja: - njeh dhe krahason zhvillimet aktuale në fushën e muzikës popullore, të kultivuar, operës dhe baletit shqiptar dhe të vendit ku jeton; - kupton rëndësinë e festivaleve kombëtare folklorike shqiptare, duke bërë lidhjen me festivalet folklorike të vendit ku jeton; - flet rreth festivaleve të ndryshme të muzikës shqiptare për të rinj;
NJË BOTË PËR TË GJITHË	- Muzika shqiptare dhe interpretimi i saj nëpër botë.	Nxënës/i/ja: - diskuton për rolin dhe vlerat e muzikës shqiptare në kulturën evropiane; - dëgjon vepra muzikore shqiptare të njohura edhe në botë; - njeh interpretuesit shqiptarë të muzikës nëpër botë si: Inva Mula, Ermonela Jaho, Saimir Pirgu, Ramë Lahaj, Tedi Papavrami, Shkëlzen Doli, Rita Ora, Dua Lipa, Bebe Rexha etj.
MËSIMI, PUNA, LOJA, KOHA E LIRË	- Institucionet arsimore e profesionale muzikore në Atdhe. - Aktivitetet muzikore në shkollë dhe në komunitet.	Nxënës/i/ja: - njeh dhe krahason shkollimin muzikor, institucionet dhe profesionet muzikore në Atdhe me ato në vendin ku jeton.

7. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Shumësia dhe larmia e interesave dhe e nevojave kulturore-arsimore të nxënësve të moshave e niveleve, e kompetencave paraprake në fusha të caktuara, e niveleve arsimore kulturore të familjeve dhe të prindërve të tyre, e faktorëve të tjerë shoqërorë e psikologjikë, ndërveprimet gjuhësore e kulturore, si dhe interferencat jo të pakta, posaçërisht në fushën e gjuhës dhe të kulturës, e bëjnë mësimin (marrjen dhe dhënien e tij) një veprimtari shumë komplekse, që është vështirë të pranohet e të identifikohet brenda teorive e shkollave, praktikave e standardeve të njohura të mësimdhënies dhe të mësimnxënies. Pra, në praktikë bëhet fjalë për një veprimtari edukativo-arsimore, përtej të gjitha "kornizave" e shkollave formale të punës, e cila kërkon një përgatitje interdisiplinare të mësuesit dhe shumë erudicion e kreativitet të atypëratyshëm.

Sigurisht që puna e parë që duhet të bëjë mësues/i/ja për zbatimin e kësaj kurrikule është *përcaktimi i kompetencave* të nxënësve në fushat e caktuara. Dhe pastaj, mbi bazën e rezultateve të këtij përcaktimi a diferencimi zgjidhen përmbajtjet, format, mjetet, metodat, teknikat e strategjitë e punës me nxënësit, si dhe me faktorët (partnerët e subjektet) e tjerë mbështetës brenda dhe jashtë shkollës. Metodat dhe teknikat e mësimdhënies janë po aq të larmishme sa edhe vetë stilet dhe mënyrat e nxënies së nxënësve. Prandaj, gjatë orës mësimore, mësuesi, që të arrijë rezultate optimale, mund të përdorë forma, teknika dhe metoda mësimore të kombinuara me njëra-tjetrën. Pra, vetë kompleksiteti i punës e kërkon këtë shumësi didaktike-metodike dhe mjetesh, ku rol të veçantë, në kushtet dhe rrethanat konkrete, kanë format, mjetet e metodat e punës së mësimit hipermedial që i referohen kompjuterit dhe internetit (e- learnings, softueret e ndryshëm, uebfaqet, portalet didaktike, rrjetet sociale etj.). Fakti që shkollat vendore dhe nxënësit shqiptarë në diasporë dhe në mërgatë janë të pajisur me këto burime didaktike paraqet një përparësi dhe, nëse përdoren në mënyrë kompetente (si nga mësuesi, ashtu edhe nga nxënësit, prindërit etj.), gjithsesi premtojnë rezultate të mira.

Meqë kjo kurrikul është e paraparë të realizohet në klasa të bashkuara (të kombinuara), të gjitha metodat, mjetet dhe format e punës i referohen një qasjeje komplementare, ndërvepruese e të integruar, brenda së cilës duhet të ndërtohet një model i pranueshëm i përfilljes së nevojave dhe zhvillimit të kompetencave të nxënësve, si dhe i krijimit të rrethanave joshëse e nxitëse (motivuese) të punës me nxënësit, në mënyrë që ata këtë mësim ta përjetojnë më tepër si *argëtim e kënaqësi*, e sa më pak si "përshtatje" e detyrim.

Lufta për kohën e lirë dhe konkurrenca e ofertave kulturore e argëtuese në shoqëritë urbane, përballë të cilave qëndron nxënësi me etjen e tij të natyrshme për sa më shumë lojë, argëtim dhe kohë të lirë, kërkojnë një qasje tjetër si të mësuesit ashtu edhe të prindit, dhe të rrethit. Bashkëpunimi e ndërveprimi pedagogjik mësues-nxënës-prind këtu është i domosdoshëm posaçërisht për evitimin e raporteve përjashtuese. Thënë thjesht, fëmijën-nxënësin duhet *ta marrë malli për shkollën shqipe* dhe nevoja për "*ndërhyrjen*" e "*trysninë*" e prindit apo të autoritetit tjetër duhet të jetë e reduktuar në minimum. Prandaj, duhet të zhvillohet e afirmohet përpjekja e mësuesit për të qenë sa më pak zyrtar, sa më pak i mbyllur, sa më pak i rreptë e "mësues" në kuptimin konvencional-kanonik, në njërën anë, dhe sa më shumë i hapur, i dashur, me sens e potencial të mjaftueshëm mirëkuptimi për nevojat e fëmijëve për lojë e argëtim, respektivisht *mësim* përmes lojës, në anën tjetër.

Sa u përket formave tradicionale të punës, *puna në grupe (të madhësive të ndryshme), në çifte dhe posaçërisht ajo individuale* qëndrojnë para formës *frontale.*

Ndërkaq në fushën e metodave aplikohen më të njohurat si: *metoda e demonstrimit (*shpjegimi, ligjërata etj.), *metoda e punës me tekst, metoda e bashkëbisedimit (diskutimet, debatet, shkëmbimi i mendimeve), metoda kërkimore-hulumtuese etj.*

Në fushën e teknikave të mësimdhënies dhe të mësimnxënies, tashmë në praktikën shkollore janë treguar shumë të suksesshme këto:

- *brainstormingu (stuhi mendimesh, gjenerim idesh*), **,** që është teknikë efektive e përshtatshme të përdoret në fillim të orës mësimore;
- *kllasteri (grumbulli apo pema e mendimeve*), që nxit nxënësit për të menduar rreth një teme ose koncepti të caktuar dhe zakonisht shërben për të krijuar lidhje midis fakteve;
- i*nsert-i-*,si sistem ndërveprues i shënimit për të menduarit dhe leximin e efektshëm, që zakonisht përdoret në pjesën kryesore dhe është efektiv, sepse nxënësi është gjithmonë aktiv dhe mban qëndrim kritik ndaj asaj që lexon;
- p*esëvargëshi*, që është teknikë e veçantë, e cila ka pesë vargje dhe kërkon përmbledhjen e informacionit në shprehjet, të cilat përshkruajnë apo reflektojnë rreth idesë kryesore të temës;
- *Xhigsou (ndërthurja*), që është teknikë e të lexuarit në bashkëpunim, ku leximi i njësisë mësimore nuk bëhet në tërësi nga ana e të gjithë nxënësve, por nxënës të caktuar janë përgjegjës për pjesë të caktuara.

Një mori teknikash të tjera si: *ditari dypjesësh, loja me role, diskutimi që zgjidh probleme, di-dua të di-mësova, rrjeti i diskutimit, diagrami i Venit, shkrimi i lirë, të mësuarit përmes projekteve, puna kërkimore në terren etj*., të përdorura përshtatshëm dhe në situata të përshtatshme didaktike, i shtojnë premisat për një sukses më të madh.

Kjo kurrikul përbëhet nga materia e integruar e këtyre fushave mësimore: *gjuhë shqipe, histori, gjeografi, kulturë muzikore, kulturë figurative.* Tematikat e dhëna e ndihmojnë mësuesin të përqendrohet në tema konkrete për nivele të caktuara. Në paralelen me klasë të kombinuara, jo vetëm që kombinohet materia e këtyre fushave mësimore, por kombinohen edhe nivelet e ndryshme të saj. Pra, bashkimet e kombinimet janë shumështresore e shumëplanëshe. P.sh., në tematikën "Identiteti im" është paraparë tema "Unë jam.....", e cila mund të realizohet duke iu qasur nga të gjitha fushat mësimore të kësaj kurrikule. Teksti i poezisë së Asdrenit *"Betimi mbi flamur",* që realisht është materie për të gjitha nivelet, mund të përdoret:

- në planin g*juhësor* (nxënësi dëgjon, shkruan, lexon, reciton poezinë, e interpreton atë me shkrim apo me gojë);
- në planin *letrar* (përjetohet figura, kuptohet dallimi poezi-tregim, shijohet gjuha e poezisë, edukohet shija, zhvillohet kompetenca përkatëse etj.);
- në planin *muzikor* (dëgjohet, këndohet dhe interpretohet në instrument muzikor);
- në planin *figurativ të arteve pamore* (nxënësi vizaton, ngjyros, modelon flamurin e simbolet tjera kombëtare etj., apo edhe bisedon rreth ndonjë krijimi artistik figurativ ku temë është flamuri ose ngjarjet konkrete rreth tij);
- në planin *historik* (nxënësi mëson për flamurin dhe momentet historike të *lidhura me të në periudha të ndryshme të historisë kombëtare);*
- në planin *gjeografik* (nxënësi bisedon e mëson për qytetet ose rajonet e ndryshme të Atdheut, të lidhura me këto momente historike, pastaj mësuesi mund të organizojë edhe temat vijuese, si p.sh., përdorimi i flamurit në institucione zyrtare, në familje dhe në festa që janë gjithashtu tema të veçanta në kuadër të tematikave të propozuara).

Për një punë të suksesshme e të qëndrueshme dhe njëkohësisht gjithëpërfshirëse (*posaçërisht në kuptimin e përfshirjes të sa më shumë subjekteve*), praktika ka dëshmuar se mësuesi duhet të mbështetet në mënyrë të veçantë:

- në ndërtimin e një modeli funksional, të përshtatshëm me rrethanat konkrete, të *bashkëpunimit me prindërit dhe komunitetin shqiptar/* formimi i këshillit (bordit) të shkollës dhe i këshillit të prindërve në nivel shkolle ose lokaliteti ku punon apo edhe në nivel më të gjerë në bashkëpunim me kolegët e tjerë shqiptarë dhe hartimi i planit

konkret të punës me detyra e përgjegjësi të adresuara dhe me një kalendar paraprak sipas zërave të punës dhe veprimtarive;

- në bashkëpunimin dhe komunikimin profesional[5]në nivel të grupimeve ose organizimeve profesionale brenda qytetit, regjionit (kantonit) ose shtetit ku punon (formimi dhe zhvillimi i *këshillave të mësuesve* apo i organizimeve të ngjashme profesionale);
- në *bashkëpunimin me shkollën dhe mësuesit e vendit mikpritës* dhe me autoritetet (subjektet) e tjera në interes të vendit (*posaçërisht me institucionet zyrtare nga fusha e shkollës, interkulturës, integrimit, emigracionit etj*.), me interes të theksuar në zhvillimin e kompetencës ndërkulturore;
- në thellimin e *bashkëpunimit me shkollat dhe institucionet e Atdheut* në të gjitha fushat (ekskursionet mësimore a vizitat e organizuara me nxënës në Atdhe sipas projekteve dinamike kulturore-arsimore, faqet e portalet e përbashkëta në NET e rrjetet sociale, takimet dhe seminaret e mbështetjes dhe të aftësimit profesional për mësueset dhe mësuesit, pjesëmarrja në veprimtari të tjera të përbashkëta me interes etj.), duke rrahur me forcë, në veçanti, zhvillimin e pikëpamjes së perceptimit të arsimit kombëtar në kompaktësinë e integralitetin e vet, pa marrë parasysh përkatësitë shtetërore dhe kufizimet kulturore e arsimore (lexo edhe kurrikulare[6]) që mund të shkaktojnë ato;
- në organizimin e veprimtarive të ndryshme kulturore-arsimore në kuadër të shkollës, prej të cilave tashmë janë afirmuar takimet vjetore me karakter garash dhe spektaklesh-afirmimesh kulturore, të njohura si *kampionatet apo konkurset e dijes* (kuizet), si dhe veprimtari të tjera publike lokale dhe më gjerë, për të cilat paraprakisht duhet të hartohet plani i punës bashkë me kalendarin përkatës, gjithnjë duke e koordinuar punën me planet e themelatave të tjera kulturore shqiptare, pastaj pjesëmarrja në veprimtaritë kulturore e ndërkulturore të vendit (programet ndërkulturore, revistat e ndryshme e shfaqjet e tjera publike ku afirmohet kultura kombëtare, si p.sh., organizimi i një manifestimi të emërtuar, ta zëmë, *"Ditët kulturore kombëtare*", që do të përfshinte paraqitjen e sa më shumë elementeve të kulturës sonë kombëtare, si p.sh., veshjet tradicionale, muzikën, vallet, ritet, ushqimet tradicionale, sportet, lojërat popullore etj.

Për më tej, duhet theksuar se kjo kurrikul është hartuar duke mbajtur parasysh para së gjithash plotësimin e disa standardeve të domosdoshme për ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit kombëtar nëpërmjet edukimit.

Zbatimi me sukses i saj varet nga faktorë shoqërorë, ekonomikë, psikologjikë, gjuhësorë etj. Ata mund të ndihmojnë ose edhe të pengojnë zbatimin e praktikave dhe të metodave formale të mësimdhënies, por një mësues i devotshëm, krijues e pasionant dhe profesionalisht i përgatitur, mund të dalë jashtë kornizave të mësimdhënies formale, për t'u krijuar nxënësve mjedis të këndshëm e stimulues, me qëllim që këta ta vazhdojnë përvetësimin e programit në mënyrë sistematike.

Metodat që duhet të përdorë mësuesi në zbatimin e programit duhet të jenë integruese, ndërvepruese dhe plotësuese të njëra-tjetrës. Ato duhet të marrin parasysh karakteristikat e niveleve moshore, nivelin fillestar të formimit gjuhësor e kulturor të nxënësve, mënyrat e tyre vetjake të të nxënit, kushtet dhe mjediset e të nxënit në

[5] Tashmë është e domosdoshme që për nevoja të bashkëpunimit, informimit dhe ndërkomunikimit profesional, në të gjitha nivelet dhe në nivel të të gjitha subjekteve (të këshillave profesionale të mësuesve, të këshillave të shkollës dhe të prindërve, të shoqatave, të vetë mësuesit dhe shkollës me të cilën udhëheq) të hapen webfaqet përkatëse, faqet në rrjetet sociale etj.

[6] Kohët e fundit në kornizat kurrikulare të edukimit/arsimimit parauniversitar në Atdhe, mbase falë mundësive të shumta që ofron komunikimi hipermedial etj., dhe të efekteve të tij, mund dhe po instalohet qasja e re e 'integrimit' të arsimimit të fëmijëve dhe të rinjve të diasporës e mërgatës në sistemin e Atdheut dhe gjithnjë e më tepër po identifikohet interesi shtetëror/kulturor i përshtatjes së këtij komunikimi e edukimi.

shkollën shqipe dhe në shtëpi, mënyrat e të nxënit në shkollat që ata frekuentojnë në vendin ku jetojnë, arsyet pse ndjekin këtë program etj. Mësuesi duhet të krijojë një atmosferë nxitëse dhe argëtuese për nxënësit, që këta ta konsiderojnë ndjekjen e shkollës shqipe si një "detyrim" që u sjell kënaqësi. Ata duhet ta ndiejnë mungesën e saj dhe, në një farë mënyre, ta shikojnë si plotësuese të shkollës që ndjekin në vendin ku jetojnë, si dhe mbushëse të veprimtarive të kohës së lirë të tyre. Kjo mund të arrihet nga një mësues i përgatitur profesionalisht, i dashur, i hapur dhe mirëkuptues për nevojat e fëmijëve për lojë e për argëtim, për mësim argëtues.

Zbatimi me sukses i programit mësimor varet dhe nga faktorë të tjerë, e jo vetëm nga dëshira e mirë dhe niveli profesional i mësuesit. Mësuesi duhet të mbështetet nga strukturat arsimore, profesionale, komunitare, të vendit ku jeton dhe të Atdheut. Roli i rrjeteve profesionale të arsimtarëve të diasporës shqiptare, por dhe i diasporave të tjera, i bordeve të prindërve, i komunitetit shqiptar, i institucioneve arsimore dhe i shkollave të vendit ku jetojnë, i institucioneve arsimore dhe i shkollave të Atdheut, është shumë i madh dhe i një rëndësie të veçantë për suksesin e programit. Bashkëpunimi me këto institucione dhe me partnerë duhet të bëhet i planifikuar dhe me strategji të qartë.

Në zbatimin e kurrikulës ndihmon dhe përgatitja e nxënësve në lëndët përkatëse në shkollat që ndjekin aktualisht fëmijët. Është mirë që mësuesi të njohë programet e shkollave në atë vend.

Publikimi i sukseseve të arritura në shkollën shqipe, nëpërmjet organizimit të veprimtarive kulturore-artistike-shkencore të vetë shkollës apo të shkollës në bashkëpunim me prindërit dhe me komunitetin e diasporës të vendit ku jetojnë, do të ndihmonin për zbatimin me sukses të programit të integruar të mësimit shqip në diasporë. Veprimtari, të tilla si: ekspozita me vizatime, veshje, objekte, fotografi, botime e shfaqje publike, olimpiada sportive me lojëra popullore, konkurse të fjalës artistike dhe të muzikës në shqip, panaire të gatimit tradicional, hapje të faqeve internet mbi veprimtaritë e shkollës etj., do të ndihmonin në sensibilizimin e fëmijëve për vlerat e kulturës shqiptare e të mësimit shqip, si dhe për forcimin e lidhjeve ndërmjet tyre dhe komunitetit ku ata jetojnë.

7.1. Gjuhë shqipe

Gjuha amtare është element kryesor i identitetit kombëtar, prandaj mësimi i saj në shkollë, sidomos për nxënësit e mësimit plotësues në diasporë, ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe. Pesha e madhe e mësimit të gjuhës amtare qëndron në faktin se ajo kryen funksion të dyfishtë: në radhë të parë si lëndë mësimore e pastaj edhe si gjuhë mësimore për lëndët tjera të përcaktuara në këtë kurrikul. Korrelacioni metodik-didaktik dhe përmbajtjesor me lëndët e tjera kërkon një qasje ndërdisiplinare dhe aplikohet me sukses posaçërisht në mësimin me projekte.

Për nxënësit jashtë atdheut është shumë i rëndësishëm krijimi i vetëdijes mbi rëndësinë e mësimit, njohjes dhe përvetësimit gradual të gjuhës shqipe. Në këtë drejtim i tërë materiali programor i kësaj kurrikule është në përputhje me moshën dhe nivelin gjuhësor të atyre që u dedikohet. Po ashtu gjuha nuk duhet të pranohet si qëllim në vetvete, por si mjet efikas i edukimit patriotik, zhvillimit të identitetit kombëtar dhe socializimit.

Organizimi i tërësive tematike përmes kategorive të komunikimit: *dëgjoj, flas, lexoj* dhe *shkruaj* dhe zbërthimi i tyre i mëtejshëm, ofrojnë mundësi të mira të përvetësimit të njohurive themelore për sistemin e gjuhës shqipe, për tekstet letrare e jo letrare dhe për formimin e tërësishëm kulturor kombëtar. Është shumë i nevojshëm zbatimi i parimit të ndërvarësisë dhe të ndërveprimit në kuadër të fushave mësimore të gramatikës dhe të komunikimit (me gojë dhe me shkrim), letërsisë, teatrit, filmit etj.

Kjo fushë lëndore, krahas përgatitjes së mirë profesionale të përgjithshme, kërkon nga mësuesi njohje të mirë jo vetëm të gjuhës standarde shqipe, por edhe të gjuhës vendore. Për realizimin e suksesshëm kontribuon edhe zbatimi i një qasjeje të hapur ndaj burimeve të shkruara dhe gojore, si dhe posedimi e përdorimi i materialeve dhe pajisjeve të ndryshme teknike dhe vënia në funksion mësimor i mediumeve[7], të cilat do të ndikonin në zgjerimin dhe thellimin e njohurive gjuhësore, letrare e kulturore të nxënësve.

Para se të fillohet me realizimin e qëllimeve të kësaj kurrikule, mësuesi përcakton *kompetencat gjuhësore ekzistuese* të nxënësve dhe në bazë të tyre diferencon mësimdhënien individuale, duke mundësuar zhvillimin dhe përparimin gradual të secilit nxënës në përputhje me nivelin gjuhësor ekzistues. Në anën tjetër, është shumë me interes edhe identifikimi i dominancës gjuhësore në kontekstin e përkatësisë së nxënësit dhe të qenit e tij ndërmjet dy ose shumëgjuhësisë, si dhe konstatimi mbi bazën e kompetencave të gjuhës së parë. Zhvillimi dhe thellimi i kompetencave të gjuhës amtare përbën mbështetje të fuqishme edhe për zhvillimin intelektual të nxënësit.

Lidhur me mësimin e shkrim-leximit fillestar, puna duhet të harmonizohet e koordinohet me atë të mësuesit në gjuhën vendase, në mënyrë që të mos krijohen situata përjashtuese-penguese (interferenca) të panevojshme. Kujdesi dhe bashkëpunimi me mësuesit vendorë është shumë i nevojshëm, në veçanti në mjediset ku gjuha e vendit nuk është me bazë alfabetin latin. Mbase problemi më i madh në këtë rast do të ishte përvetësimi i atyre fonemave e grafemave të veçanta të gjuhës shqipe (shkronjat dyshe), të cilat nuk i kanë as gjuhët e tjera me alfabet latin. Rekomandohet që gjuha amtare të pasojë gjuhën vendore dhe të kihet shumë kujdes në përdorimin e metodave. Në përgjithësi rikthimi kah metodat me fillim fono-sintetik dhe silabik duket se paraqet zgjidhjen më optimale profesionale, aq më tepër kur janë evidente vështirësitë në të cilat zhvillohet puna praktike. Megjithatë, në situatat kur nxënësit dëshmojnë që kanë njohuri të mëparshme dhe premisa paraprake të mjaftueshme të suksesit, mësuesi mund të përdorë edhe metoda të tjera.

Pra, është e nevojshme një shumësi metodash me një zgjidhje të qëlluar në raport me kompetencat paraprake të nxënësve dhe aftësitë e tyre njohëse. Në fokus të punës së mësuesit duhet të jetë ndërgjegjësimi i nxënësit për fonemat e grafemat e gjuhës amtare. Puna e veçantë me tingujt, stërvitjet e vazhdueshme të leximit, zotërimi e pasurimi i fjalësit dhe semantika e fjalës (kuptimi) janë po ashtu fusha që meritojnë kujdes të veçantë, posaçërisht në raport me gjuhën vendore.

Fakti që nxënësit në diasporë jetojnë në një shoqëri (*dhe jo rrallë edhe në familje)* dy ose shumëkulturore ku shkollimi e komunikimi-ndërveprimi kulturor janë realitete që preken, punën e mësuesit e bën me komplekse dhe kërkon po ashtu një përgatitje të mjaftueshme profesionale dhe ndërdisiplinare. Mësuesi, me shkathtësi e profesionalizëm, duhet ta shfrytëzojë ndërveprimin gjuhësor, prandaj njohja e gjuhës së vendit është e domosdoshme. Gjithnjë synim parësor në punën me nxënësit duhet të jetë ngritja e tij mbi bazën e gjuhës amtare, që është edhe gjuha e identitetit të tij burimor. Duke krijuar fushë të mjaftueshme dhe të baraspeshuar për ndërveprim dhe mësim edhe *kontrastiv* posaçërisht në periudhën sensitive të mësimit të gjuhëve (moshat e reja), ai ua pret rrugën interferencave gjuhësore që zakonisht janë pasojë e mungesës së kompetencës së mjaftueshme në gjuhën amtare. Në këtë mënyrë, ndërveprimi gjuhësor shihet si mënyrë e suksesshme zhvillimore në fushë të kompetencave gjuhësore dhe njëkohësisht reflekton pozitivisht edhe në ndërkomunikimin dinamik kulturor. Në këtë plan është i nevojshëm një bashkëpunim

[7] Interneti dhe mundësitë që ofron ai janë pothuaj të pakrahasueshme, prandaj, me përkujdesjen dhe mbështetjen e mësuesit dhe të prindit, duhet të shfrytëzohet si mjet mësimor.

dinamik me mësuesin e gjuhës së vendit pritës, respektivisht ndërtimi i një korrelacioni funksional në mësimin e gjuhës amtare dhe të gjuhës tjetër.

Po ashtu, mësuesi duhet të ketë parasysh faktin që nxënësit, duke ardhur nga treva të ndryshme shqiptare, ku të shumtën e rasteve gjuha e tyre shqipe e familjes është ose dialektore ose lokale (jo standarde), do të kenë probleme me standardin. Në këto raste, ai duhet të jetë tolerant, me ndjeshmëri të duhur dhe jo përjashtues në raportet me dialektet. Ai, vetëm duke vepruar me profesionalizëm mund të insistojë në përvetësimin e gjuhës standarde shqipe. Gjuha shqipe jashtë Atdheut, edhe kur nuk është standarde në masën e dëshirueshme, gjithnjë identifikohet me të (Atdheun). Ndërsa vendi i prejardhjes është krenaria e parë e njeriut. Prandaj, fleksibiliteti dhe durimi janë tipare të pashmangshme të mësuesit të suksesshëm. Të gjitha këto duhet të jenë në funksion të motivimit edhe të nxënësit, edhe të mësuesit. Në këtë kontekst mësuesi me krenari e sheh rolin e tij personal edhe prej *misionari.*

7.2. Histori

Zhvillimi i qëndrimit pozitiv ndaj vlerave, traditës, besimit dhe kulturës së popullit shqiptar është një nga qëllimet më të rëndësishme të kësaj kurrikule. Qasja e mësimdhënies në realizimin e temave nga fusha lëndore e historisë përkon me natyrën e integruar të kurrikulës dhe nuk e përfill vijën kronologjike të ngjarjeve, por i referohet ndërveprimit kurrikular-ndërpërmbajtjesor.

Në mënyrë të veçantë mësuesi i motivon dhe përgatit nxënësit për kuptimin e kundrimin multiperspektiv të historisë (*i bën të jenë të hapur ndaj diversitetit dhe shumësisë së pikëpamjeve të historisë, duke përfshirë aspektin shoqëror, kulturor, ekonomik, politik etj*.).

Metodat e mësimdhënies duhet t'i mundësojnë nxënësit që të zhvillojë njohuritë (*informacionet faktike për të kaluarën*), shkathtësitë (*e analizës dhe të reflektimit kritik mbi shkaqet dhe pasojat e ngjarjeve historike*), si dhe qëndrimet personale ndaj ngjarjeve historike.

Temat e propozuara të kësaj kurrikule nga fusha lëndore e historisë kanë për qëllim që të zhvillojnë këtë qëndrim pozitiv të nxënësve dhe ndjenjën e krenarisë për identitetin e tyre kombëtar bashkë me qëndrimin tolerant e dashamirës ndaj popujve të tjerë në kuadër të familjes evropiane dhe më gjerë.

Këto tema zgjidhen në përputhje me nivelin dhe zhvillimin e aftësive gjuhësore (të folurit, të dëgjuarit, të lexuarit e të shkruarit) dhe duke nxitur në mënyrë të veçantë analizën, si dhe reflektimin kritik ndaj fakteve dhe burimeve konkrete. Ato shumë mirë mund të kombinohen edhe me historinë e zhvillimit të gjuhës amtare, të letërsisë dhe të arteve të tjera e të kulturës kombëtare shpirtërore e materiale dhe në rastin konkret ndërveprohen brenda përmbajtjeve e njësive konkrete, të përfshira në këtë kurrikul.

Për të realizuar këtë fushë lëndore, mësuesi përdor mjete të ndryshme, si p.sh., hartat, burimet e shkruara, burimet gojore, materiale, pajisjet multimediale e të tjera, duke mos lënë anash edhe vizitat praktike në lokacione të ndryshme historike, në muze, në galeri etj. Një aktivitet i të mësuarit me shumë interes dhe, sa mbështetës po aq edhe i dashur për nxënësit, do të ishte *ekskursioni në Atdhe,* por gjithnjë si vizitë e organizuar me qëllim njohës e mësimor dhe edukativ.

Mësuesi do të kujdeset që të aplikojë njërën prej metodave më interesante të mësimdhënies bashkëkohore të historisë, të ashtuquajturën metoda e *historisë orale,* që përqendrohet në rrëfimet e dëshmitarëve të gjallë të ngjarjeve të ndryshme historike.

Përmes projekteve të vogla në tema të caktuara, ku mund të ngërthehen të gjitha aspektet e zhvillimit historik të shoqërisë (*politika, ekonomia, arti e kultura*), nxitet mendimi kritik dhe puna e pavarur e hulumtuese (*individuale dhe në grup*).

7.3. Gjeografi

Për realizimin me sukses të temave nga gjeografia e Atdheut është e domosdoshme të zbatohen metoda, teknika e forma të shumëllojshme të punës dhe një kompleks i tërë procedurash: informacioni i ri, përsëritje, përforcim, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike etj. Përdorimi i mjeteve mësimore siç janë: skicat, vizatimet, peizazhet, hartat, modelet, diagramet, grafikonët, instrumentet dhe mjetet të tjera teknike bashkëkohore (*kompjuteri, interneti*) e konkretizojnë mësimin nga kjo fushë lëndore dhe nxitin nxënësit për punë të pavarur e hulumtuese.

Qasja ndaj temave, që i takojnë kësaj fushe lëndore, duhet të jetë krejtësisht praktike dhe në funksion të përdorimit të gjuhës për nevoja të komunikimit me gojë dhe me shkrim, si dhe në funksion të aftësisë për lexim, analizë dhe interpretim të materialeve (teksteve) që kanë të bëjnë me këto tema. Funksioni tjetër është njohës, gjegjësisht është marrje e informacioneve të ndryshme e të mjaftueshme për relievin, florën, faunën, vendbanimet (*fshatrat dhe qytetet*), popullsinë dhe organizimin shoqëror të Atdheut, në përputhje me nivelin e caktuar dhe në bashkërenditje me mësimet që nxënësit marrin nga kjo fushë mësimore në mësimin bazë. Prandaj, mësuesi patjetër duhet të bashkëpunojë me mësuesin e shkollës vendore për të pasur parasysh njohuritë paraprake që kanë nxënësit nga kjo fushë dhe për të arritur që sidomos në nivelin e tretë të analizojnë dhe të krahasojnë njohuritë mbi aspektet gjeografike të vendit ku jetojnë me ato për Atdheun.

Ekskursionet mësimore në Atdhe paraqesin një mundësi të shkëlqyeshme për zhvillimin e natyrshëm të kompetencave gjeografike, prandaj duhet të shikohen me përparësi dhe të gjenden rrugë e mjete të realizimit të tyre.

7.4. Kulturë muzikore

Në këtë fushë përmbajtjet janë kryesisht të orientuara në funksionin e muzikës për edukimin patriotik duke zhvilluar te nxënësit njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e shprehitë pozitive në raport me artin muzikor kombëtar.

Duke pasur parasysh faktin se mësimdhënia e muzikës është e mundshme të realizohet në mënyrë të suksesshme vetëm nga mësuesi, i cili ka përgatitje solide muzikore e që në të vërtetë mjerisht rastet e tilla janë të rralla, rekomandohet bashkëpunim më i ngushtë me profesionistë të muzikës, si p.sh., me mësuesin e muzikës së shkollës ku nxënësit vijojnë mësimin e rregullt, me prindërit e subjekte të tjera me edukim të mjaftueshëm muzikor, muzikantë që veprojnë në grupe e shoqata të ndryshme profesionale e amatore muzikore-kulturore etj. Mësuesi i shkathtë, një ndihmë të konsiderueshme mund të ketë edhe nga nxënësit e tij që ndjekin shkolla muzike ose arsimim shtesë muzikor në fusha të caktuara. Një raport ndërveprues dhe partneriteti me ta paraqet përparësi profesionale të mësuesit dhe rritje të suksesit të tij dhe të nxënësve. Gjithë kjo do të thotë se është shumë i mirëseardhur inkurajimi i nxënësve të talentuar në këndim apo lojë instrumentale, që ata të marrin iniciativën e realizimit muzikor të shembujve në rastet kur mësuesi nuk ka përgatitjen e duhur muzikore.

Mësuesi ka për obligim të realizojë materialin muzikor të propozuar në këtë kurrikul për t'i përmbushur objektivat e mësimit plotësues në diasporë.

Në këtë lloj mësimi kryesisht do të përdoren dy veprimtaritë kryesore muzikore:

a) interpretimi (këndimi dhe interpretimi në instrumente muzikore);

b) dëgjimi i muzikës.

a) ***Interpretimi muzikor***

Mësuesi gjatë zgjedhjes së këngëve dhe të melodive instrumentale duhet të udhëhiqet kryesisht nga shembujt e propozuar në katalogun e kësaj kurrikule. Përzgjedhja e materialit muzikor (këngëve për këndim ose melodive instrumentale) është bërë ose bëhet /në rastet shtesë/ në përputhje me temat mësimore të propozuara nga fushat e tjera mësimore të kësaj kurrikule.

Në fushën e këndimit kënga popullore është më e afërt për fëmijët, ngase ajo është pjesë e pandashme e rritjes dhe zhvillimit të tyre dhe i shoqëron ata në familje dhe më gjerë. Zgjidhen këngët më përfaqësuese dhe që paraqesin margaritarë të këngës popullore shqiptare, gjithnjë duke pasur parasysh njëkohësisht përmbajtjen e tyre tekstore, e cila duhet t'i përgjigjet moshës dhe aftësive të tyre marrëse. Meqë këngët tregojnë shpirtin e një populli, është mirë që mësuesi të jetë sa më gjithëpërfshirës në gjeografinë e këngës popullore shqiptare, duke përfshirë këngë, melodi, lojëra e valle nga të gjitha trojet shqiptare. Nga aspekti metodik muzikor, këngët duhet të këndohen në intonacion sa më të saktë ose me imitim, ose duke u ndihmuar me tekstin notal muzikor. Kënga mundësisht të shoqërohet me përcjellje instrumentale nga mësuesi ose nga nxënësit që interpretojnë në ndonjë instrument muzikor. Ndihmesë për mësuesin mund të jenë edhe reproduktimet e ndryshme që mundësohen nga përdorimi dhe njohja e teknologjisë bashkëkohore: CD-të origjinale, prezantime multimediale (DVD, video etj), MP3, MP4, pastaj materiale të autorizuara dhe legale që mund të gjenden në internet etj. Megjithatë, mësuesi duhet ta dijë se asgjë nuk mund ta zëvendësojë këndimin origjinal (të gjallë) dhe emocionet e fuqishme që nxënësit përjetojnë me atë rast.

Në fushën e *lojës në instrumente muzikore* mësuesi bashkëpunon e koordinon veçmas me nxënësit e angazhuar në kuadër të shkollimit të rregullt, të cilët duke e njohur përdorimin e instrumenteve muzikore të fëmijëve (të ORFI-t) për shoqërimin ritmik të këngëve që i këndojnë në klasë, por edhe për interpretimin e melodive të thjeshta muzikore, janë mbështetje e mirë edhe për mësimin e muzikës shqiptare. Kjo duhet të pasurohet me futjen në përdorim edhe të instrumenteve muzikore popullore, që përdoren në muzikën shqiptare si: çiftelia, dajrja (defi), fyelli dhe instrumente të tjera popullore (gërrenjëza, daullet e vogla, bilbili etj.). Nxënësit duhet të inkurajohen për shoqërim ritmik apo harmonik të këngëve dhe luajtje të veçanta instrumentale në kuadër të aktiviteteve të lira në shkollë dhe jashtë saj.

b)Dëgjimi i muzikës

Dëgjimi i muzikës është veprimtari edukative e arsimore muzikore që, në këtë lloj mësimi, ka për synim kryesor zgjerimin e njohurive të nxënësve për krijimtarinë muzikore kombëtare përmes dëgjimit dhe përjetimit estetik të veprave konkrete muzikore.

Në këtë veprimtari mësuesi zgjedh shembuj muzikorë për dëgjim, duke u bazuar në dy kritere themelore:

- Materialet mësimore që punohen të jenë në përputhje me tërësitë tematike të propozuara dhe të jenë në funksion të plotësimit të realizimit të rezultateve të të nxënit për ato tërësi tematike.
- Të fokusohen figurat dhe veprat e shquara përfaqësuese kombëtare të të gjitha zhanreve të muzikës shqiptare, që do të thotë përfshirje e krijuesve (kompozitorëve) dhe interpretuesve muzikorë, të cilët e përfaqësojnë denjësisht muzikën shqiptare në botë.

Në kuadër të kësaj veprimtarie, në nivelin e dytë dhe të tretë, nxënësit nxiten edhe për reflektim e vlerësim individual të zhvillimeve muzikore në Atdhe, duke i krahasuar ato me prirjet aktuale të zhvillimeve muzikore në vendin ku jetojnë e edhe më gjerë. Në këtë rast zgjerohet horizonti i njohurive të tyre nga fusha e muzikës kombëtare dhe njëkohësisht

zhvillohen edhe kompetencat gjuhësore për komunikim e prezantim (me gojë dhe me shkrim) individual e në grupe mbi këto tema.

Ndërveprimi me fushat e tjera lëndore të kurrikulës është i domosdoshëm, ngase vetë lloji i mësimit të integruar të paraparë me këtë kurrikul kërkon që muzika të jetë në shërbim të zhvillimit të ndjenjës e të identitetit kombëtar dhe të aftësimit të nxënësve për të komunikuar e për t'u shprehur në gjuhën shqipe.

7.5. Kulturë figurative

Në mësimin shqip në diasporë e në mërgatë kultura figurative ka për qëllim kryesisht njohjen me vlerat artistike kombëtare. Kjo bëhet duke iu ofruar nxënësve veprat më të shquara e antologjike të krijuesve që kanë bërë emër në Atdhe, por edhe në nivel ndërkombëtar. Ato, kur ka mundësi, ofrohen, shijohen e përjetohen në origjinal apo edhe përmes reproduktimeve në tekste, në multimedia, internet etj.

Nxënësit, për t'u shprehur figurativisht në lidhje me temat e caktuara, inkurajohen që të përdorin mjete e materiale të ndryshme, si dhe shkathtësitë e tyre krijuese që i zotërojnë tashmë. Zakonisht ata udhëzohen që këto krijime t'i bëjnë si detyra të pavarura në shtëpi ose në kuadër të mësimit në shkollën vendore.

Mësuesi udhëzohet të realizojë me nxënësit vizita te krijuesit e njohur shqiptarë që jetojnë e veprojnë në vende te ndryshme (aty ku ka mundësi), si dhe vizita në galeri e muze (ku ruhen edhe vepra shqiptare). Në këtë plan, zhvillimi i një shpirti kërkues-hulumtues për veprat dhe krijuesit shqiptarë jashtë Atdheut është i domosdoshëm..

Nxënësit, po ashtu, udhëzohen për realizimin e projekteve të ndryshme të pavarura kur janë në Atdhe (krijime, biseda me krijues, vizita galerive kombëtare ose atyre private të krijuesve të shquar) dhe forma të tjera që i nxisin ata të kenë qëndrim pozitiv ndaj artit figurativ kombëtar.

Mësuesi, në programet kulturore publike të përgjithshme në kuadër të shkollës shqipe apo të aktiviteteve kulturore të komunitetit shqiptar në mjedisin ku gjendet shkolla, si dhe në programe e projekte ndërkulturore (*por edhe të veçanta e tematike*), duhet të organizojë dhe të bashkorganizojë ekspozita të punimeve më të mira të nxënësve, të cilat e afirmojnë punën e tyre dhe i vënë ata në raporte ndërvepruese të komunikimit kulturor-artistik me veten, familjen, rrethin, komunitetin që i përkasin dhe njëkohësisht edukohen më tej.

Pra, për realizimin me sukses të kësaj kurrikule, respektivisht për kompletimin e personalitetit të nxënësit në aspektin kulturor-kombëtar, bashkëpunimi me familjet dhe komunitetin më të gjerë është shumë i rëndësishëm. Nxënësi duhet të vetëdijesohet dhe të motivohet që në vendin ku jeton këtë kulturë ta prezantojë si pjesë të identitetit të tij personal dhe kombëtar dhe të jetë krenar me të.

Mësuesi gjatë vitit shkollor organizon dhe prezanton para shkollës, prindërve dhe komunitetit programe të larmishme kulturore-artistike kombëtare.

8. KUADRI MËSIMOR DHE PËRGATITJA

Meqë sistemi ynë arsimor ende nuk përgatit staf (kuadër) përkatës profesional, mësimin orientimisht mund ta zhvillojnë mësues të profileve si më poshtë:

- Gjuhë dhe letërsi shqipe,
- Histori,
- Gjeografi,
- Arte,
- Cikël fillor (mësues/e klase),
- Etj.

Megjithatë, përkrah këtyre kritereve formale të kualifikimit shkollor, mësues/i/sja posaçërisht duhet të dëshmojë:

- njohje të shkëlqyeshme të gjuhës dhe të letërsisë shqipe (gjuha standarde, gramatika, drejtshkrimi, drejtshqiptimi, stilistika, letërsia etj.);
- përgatitje dhe aftësi solide në të gjitha veprimtaritë themelore gjuhësore (të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit, të lexuarit);
- njohje të mjaftueshme të përgjithshme të kulturës shqiptare;
- njohje të historisë dhe të gjeografisë së Atdheut;
- njohje të artit muzikor dhe të arteve pamore;
- njohje të mjaftueshme të kulturës shqiptare në përgjithësi;
- edukim të mjaftueshëm artistik muzikor dhe figurativ;
- aftësi e shkathtësi interpretuese në këndim, vallëzim, instrumente muzikore, lojë etj.

Po ashtu, një listë kriteresh iu referohen standardeve përkatëse, si :

- përgatitje shkencore për lëndën/fushën mësimore,
- njohuri të mjaftueshme për kurrikulën dhe planifikimin e saj,
- kompetenca themelore të mësimit (mësimdhënie, mësimnxënie),
- vlerësim i të nxënit,
- gjithëpërfshirje dhe përkujdesje të duhur ndaj nxënësit,
- zhvillim profesional individual i vazhdueshëm,
- bashkëpunim me komunitetin,
- komunikim dinamik dhe etikë të duhur.

Mësues/it/et vazhdimisht duhet t'i thellojnë kompetencat e tyre profesionale dhe të ndjekin seminaret dhe format e tjera të aftësimit të vazhdueshëm profesional që i zhvillojnë institucionet e shtetit ku punojnë e jetojnë, si dhe ato të institucioneve të Atdheut (në mënyrë të veçantë projektet e MASHT-it të Kosovës, MASR-së të Shqipërisë etj.)

9. MJEDISI DHE MJETET MËSIMORE

Pamundësia për ta bërë një zgjedhje unike ose përafërsisht unike në kuptimin e organizimit dhe të kushteve të punës, për shkak se aktualisht në shtete dhe rrethana të ndryshme ekzistojnë forma e mënyra të ndryshme të organizimit të mësimit plotësues në gjuhën amtare dhe me status jo të njëjtë (prej formave vendore zyrtare si: *mësim i integruar* ose *gjysm*ë *i integruar, mësim integrativ, kurse të gjuhës dhe të kulturës së origjinës,* kurse të tilla mbi bazën e *projekteve të përkohshme ndërkulturore* e deri te zgjidhjet sipas *formave të vetorganizimit qytetar kulturor-arsimor* të shqiptarëve; *shkolla dhe kurse në kuadër të shoqatave e të klubeve,* përfshirë dhe ato *private-komerciale),* nuk lë mjaft shteg për të folur për standardet e mjedisit (hapësirës) dhe mjeteve mësimore (pajisjeve). Parësore është që të punohet në realizimin e të drejtës së shfrytëzimit pa kufizime dhe mjaftueshëm të hapësirave shkollore, si dhe e përdorimit të të gjitha pajisjeve dhe mjeteve mësimore që posedon shkolla vendore. Po ashtu si mjedise mësimore konsiderohen të gjitha ambientet (me pajisjet e tyre në funksion të mësimit) ku mbështetet realizimi i kësaj kurrikule (*shtëpia-ambienti familjar, ambientet e shoqatave e të klubeve kulturore e sportive etj.).* Është e domosdoshme edhe puna në krijimin e mediotekave për nevoja të shkollës, ku përveç librave (*biblioteka*) dhe mediumeve të tjera deri tradicionale, rol parësor do të kishte sigurimi dhe shfrytëzimi me kulturë profesionale i mjeteve moderne (*kompjuteri, interneti dhe pajisjet e ndryshme multimediale*). Përdorimi i internetit si mjet mësimor realisht duhet të favorizohet dhe nënkupton edhe një orientim kah përgatitja për një informatizim të plotë të shkollës (mësimit). Mësuesit, po ashtu, japin edhe udhëzimet

përkatëse për mirëpërdorimin në shkollë, në shtëpi e gjetiu të uebfaqeve, rrjeteve sociale e të portaleve të ndryshme mësimore-kulturore që ekzistojnë apo edhe mund të bëhen në të ardhmen (edhe mbi bazën e kësaj kurrikule).

10.UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Verifikimi dhe vlerësimi i shkallës së përvetësimit të diturive nga nxënësit është proces tepër i rëndësishëm për zbatimin e suksesshëm të kësaj kurrikule. Për këtë arsye rekomandohet që vlerësimi të përqendrohet më tepër në aspektin cilësor të arritjes së qëllimeve të përgjithshme dhe specifike të kësaj kurrikule.

Aktualisht bëhet kryesisht i ashtuquajturi vlerësim i brendshëm. Por, në rrethana e kushte më të favorshme, mund të aplikohet edhe vlerësimi i jashtëm.

Vlerësimi është proces i vazhdueshëm dhe sistematik i arritjes së nxënësit me qëllim që:

- të sigurojë informacion rreth përparimit të nxënësve;
- t`u sigurojë nxënësve informacion mbi arritjen e tyre;
- t`i motivojë nxënësit;
- të sigurojë realizimin e rezultateve të të nxënit;
- të vlerësojë gatishmërinë e nxënësve për nxënie në të ardhmen.

Në planin tipologjik, mësuesi, varësisht prej situatës konkrete, do të zbatojë-aplikojë tipa tashmë të njohur të vlerësimit si:

- *vlerësimin diagnostikues***,** i cili te nxënësi përcakton dobësitë, vështirësitë, problemet dhe njëkohësisht i identifikon edhe nxënësit me nevoja të veçanta;
- *vlerësimin formues***,** i cili e udhëzon mësuesin në planifikim, kurse nxënësit i ndihmon në identifikimin e vështirësive gjatë nxënies (punës) me qëllim që t'u ndihmojë dhe të plotësojë nevojat e tyre për nxënie më të suksesshme;
- *vlerësimin klasifikues* përmes të cilit **c**akton pozitën e nxënësit në raport me shkathtësitë e zotëruara paraprake dhe rezultatet e parashikuara;
- *vlerësimin në bazë të kritereve***,** që i referohet përmbushjes së kritereve të caktuara në raport me një standard të caktuar dhe ku mësuesi siguron informacion të mjaftueshëm për identifikimin e vështirësive të nxënësve dhe caktimin e modaliteteve për kapërcimin e tyre;
- *vetëvlerësimin,* që realisht është proces i mbledhjes, analizimit, interpretimit të informacionit dhe veprimtarisë që nxënësi e bën vetë me anë të ndonjë mjeti vlerësues;
- *vlerësimin përmbledhës***,** i cili bëhet me qëllim që të zbulojë shkallën e arritjes së rezultateve pas një periudhe të caktuar të mësimdhënies (p.sh., pas një kapitulli, gjysmëvjetori, viti...etj.).

Në anën tjetër vlerësimi duhet kuptuar si një veprimtari që bazohet në *kontrollin e përditshëm* të punës së nxënësit në klasë dhe, po ashtu, duhet të jetë edhe një *proces,* që i referohet mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë gjatë kryerjes së një pune ose detyre në zhvillim etj. Në fund të vitit bëhet i ashtuquajturi *vlerësimi përfundimtar,* që është një punë komplekse e sintetike dhe duhet të jetë sa më afër saktësisë e objektivitetit.

Detyrat e shtëpisë dh*e puna e pavarur* sigurojnë informacione për vazhdimin dhe zgjerimin e njohurive të nxënësve në mënyrë të pavarur dhe për përvetësimin e njësive të mësuara. Në rast të paraqitjes së vështirësive, ndihma e prindit është e dobishme deri në masën kur nxënësi vetëm ndihmohet që të hulumtojë për zgjidhjen e detyrës së kërkuar nga mësimdhënësi.

Mësuesi duhet të zgjedhë dhe të zbatojë numër të mjaftueshëm instrumentesh për matje dhe vlerësim, ndër të cilat më të njohurat janë:

- vrojtimi;
- pyetësori (vetëvlerësimi);
- raporti me shkrim i një punë praktike apo i një hulumtimi;
- të shprehurit me gojë;
- të shprehurit me shkrim;
- performanca artistike;
- dosja apo portofoli (vetëvlerësimi);
- testi i arritshmërisë i ndërtuar nga kërkesa (pyetje) me përgjigje alternative të shumta, me përgjigje të hapura të shkurta dhe me përgjigje të hapura të zgjedhura.

Vlerësimi me notë i nxënësve bëhet në formë përshkrimi sipas tri shkallëve të vlerësimit:

- *mjaftueshëm,*
- *mirë,*
- *shumë mirë.*

Në përputhje me dispozitat dhe kriteret vendore, nota bartet në dokumentin /librezën a dëftesën e nxënësit. Po ashtu, në përputhje me dispozitat e vendit pritës, ajo do të duhej të ndikonte edhe në suksesin e përgjithshëm të nxënësit në shkollën e rregullt. Nota do të bartet edhe në dokumentet tjera të nxënësit, të nxjerra nga bartësit e organizimit të shkollës-mësimit.

11.BURIMET E REKOMANDUARA TË TË NXËNIT

Gjuhë shqipe

Në ndërtimin e kësaj kurrikule janë dhe burimet e rekomanduara të të nxënit që shkojnë sipas niveleve dhe grup-moshave të kësaj kurrikule, po ashtu dhe sipas lëndëve-fushave mësimore të programit.

Hartuesi i tekstit mësimor dhe i mjeteve të tjera mësimore, si dhe mësuesit janë të lirë t' i shtojnë edhe njësi të tjera tekstore (letrare e jo letrare) mjete mësimore e burime tjera me interes nga të gjitha fushat kurrikulare, por gjithnjë në përputhje me parimet, qëllimet, rezultatet dhe përmbajtjet e kësaj kurrikule.

Si burime të rekomanduara të të nxënit konsiderohen:

- tekstet dhe mjetet e tjera mësimore që do të hartohen në bazë të kësaj kurrikule;
- tekstet, mjetet mësimore dhe literatura ndihmëse sipas niveleve dhe grup-moshave të këtij programi, që përdoren në Shqipëri dhe në Kosovë (klasat 1-9...), të miratuara nga ministritë respektive;
- tekstet, mjetet mësimore dhe literatura ndihmëse sipas lëndëve dhe fushave mësimore,
- CD, fotografi, posterë e mjete të tjera ilustruese nga trevat shqiptare;
- portalet didaktike, rrjetet e përshtatura sociale, si dhe mundësitë, mjetet e format e tjera që ofrojnë kompjuteri dhe interneti.

Niveli i parë		
Klasa I	**Klasa II**	**Klasa III**
- Abetarja. - Plotësor i abetares. - Materiale të tjera ndihmëse për nxënësit.	- Përralla, këngë dhe gjëegjëza për fëmijë nga letërsia gojore shqiptare. - Naim Frashëri "Të vegjlit". - Agim Deva "Viti i Ri". - Tasim Gjokutaj "Kush e hëngri akulloren". - Rifat Kukaj "Shkopi magjik" (poezi). - Arif Demolli "Zogu cicëron" (prozë). - Adelina Mamaqi "Lodërzat e alfabetit". - Gaqo Bushaka "Çufoja dhe bubi kaçurel". - Astrit Bishqemi "Maçoku me celular". - Rrahman Dedaj "Tre diejt e Dianës" (prozë). - Viron Kona "Eh, more bubulino".	- Përralla, këngë, anekdota dhe gjëegjëza për fëmijë nga letërsia gojore shqiptare. - Sami Frashëri "Dheu është flori". - Bedri Dedja "Shkolla e pyllit". - Gaqo Bushaka "Ariu artist" - Naim Frashëri "Të vegjlit" (poezia "Zogu dhe djali"). - Asdreni "Poezi të zgjedhura". - Kostandin Kristoforidhi "Abetare" (Ylli i vogël lart në qiell). - Ndre Mjeda "Dimri dhe plaku". - Fejzi Bojku "Zilet shkollore". - Hajro Ulqinaku, "Magjia e detit". - Odhise Grillo "Historia e Skënderbeut". - Naum Prifti "Nëna e diellit". - Dritëro Agolli "Fabula" (fabula "Kali dhe gomari") - Xhevat Beqaraj "Unë, dielli dhe retë". - Skënder Hasko "Dinakja me vesh të shpuar". - Abdullah Thaçi "Në pritje" (poezi). - Agim Deva "Të mbjellim nga një dru" (poezi). - Rifat Kukaj "Pjeshkët" (prozë).

Niveli i dytë		
Klasa IV	**Klasa V**	**Klasa VI**
- Përralla, gjëegjëza, anekdota, legjenda, këngë nga letërsia gojore shqiptare. - Naim Frashëri "Vjersha për mësonjëtoret e para" (fabulat e Naimit). - Çajupi "Përralla të zgjedhura". - Faik Konica "Vepra" (proza "Bora") - Rifat Kukaj "Kosova"	- Përralla, gjëegjëza, anekdota, legjenda, këngë nga letërsia gojore shqiptare. - Arif Demolli "Në kafaz tërë gaz". - Ernest Koliqi "Gjurmat e stinve" (poezi "Shën Gjergji". - Mitrush Kuteli "Tregime të moçme shqiptare" (tregimet "Rozafati" ose "Ymer Agë Ulqini".	- Përralla, gjëegjëza, anekdota, legjenda, këngë lirike dhe historike nga letërsia gojore shqiptare. - Konstandin Kristoforidhi "Gjahu i malësorëve". - Naim Frashëri "Histori e Skënderbeut". - Çajupi "Mëmëdheu". - Mitrush Kuteli "Tregime të moçme shqiptare" (proza "Fuqia e Mujit"). - Faik Konica "Vepra" (proza

(poezi). - Ali Huruglica "Fëmija dhe zogu" (poezi). - Zejnullah Halili "E bukura e nëndheut" (prozë). - Ymer Shkreli "Muajt e vitit" (poezi). - Vehbi Kikaj "Ti dëborë ke mbuluar malet" (poezi) . - Sulejman Salihu "Lindi udhëton për Kosovë". - Dritëro Agolli "Çudira dhe marrëzira". - Rushit Ramabaja "Çka tha Gjergji" (prozë). - Rexhep Hoxha "Hëna e Zelandës së Re" (fragment). - Bedri Dedja "Heroizmat e Fatbardh Pikaloshit". - Odhise Grillo "Gabimet e veshkaushit". - Ibrahim Rugova "Erdhi vjeshta" (poezi). - Skënder Hasko "Maçoku i katrahurës". - Bardhyl Xhama "Zjarrfikësi i pyllit". - Kiço Blushi "Beni ecën vetë".	- Dhori Qiriazi "Siç thonë njëherë…" - Asdreni "Poezi të zgjedhura" (poezia "Betimi mbi flamur"). - Rexhep Hoxha "Plaku i liqenit" (prozë). - Anton Pashku "Andrra e Afrimit" (prozë). - Rrahman Dedaj "Medaljoni" (prozë) - Migjeni "Novelat e qyteti të veriut" (tregimi "Luli i vocërr"). - Adem Gajtani "Këngë për princeshën e zogjve" (poezi). - Agim Deva "Pikniku i rrugës" (poezi). - Vehbi Kikaj "Këngët për nipin e vogël" (poezi). - Abdullah Thaçi "Pemë e vjetër, pemë e re" (poezi). - Gaqo Bushaka "Përralla u la për nesër". - Martin Camaj "Vepra" (proza "Lepurushi"). - Moikom Zeqo "Kalërosit dardanë". - Anton Nikë Berisha "E Bukura e Dheut" (fragment). - Gani Xhafolli "Me atë yll ka biseduar edhe Agroni" (prozë). - Vedat Kokona "Lulja dhe shega". - Xhevat Beqaraj "Shtëpia e bubit". - Tasim Gjokutaj "Vajza që u bë bletë". - Bardhyl Xhama "Pse qau delfini?".	poetike "Anës liqenit"). - Migjeni "Novelat e qytetit të veriut" (proza "Zeneli"). - Qamil Batalli "Dy Teuta" (prozë). - Nexhat Halimi "Mbrëmje në Ulqin" (poezi). - Anton Pashku "Klithma" (prozë). - Arif Demolli "Lushi si askush" (fragment). - Ymer Elshani "Plaku me violinë" (prozë). - Murat Isaku "Ndizni edhe një qiri" (poezi). - Rrahman Dedaj "Zogu dhe kulla" (prozë). - Lasgush Poradeci "Vallja e yjeve" ose "Ylli i zemrës" (poezia "Poradeci"). - Ferit Lamaj "Dhelpra, rrushtë dhe Ezopi". - Dritëro Agolli "Çudira dhe marrëzira". - Bilal Xhaferri "Vepra" (poezia "Baladë çame"). - Bardhosh Gaçe "Lumi im s'fle". - Dionis Bubani "Çapaçuli". - Bedri Dedja "Presidenti i Planetit të Kuq". - Anton Pashku "Një natë në det" (prozë). - Xhevahir Spahiu "Zogj të kaltër". - Ismail Kadare "Princesha Argjiro".

Niveli i tretë		
Klasa VII	**Klasa VIII**	**Klasa XI**
- Përralla, gjëegjëza, anekdota, legjenda, këngë lirike dhe historike nga letërsia gojore shqiptare. Këngë e Gjergj Elez	- Përralla, gjëegjëza, anekdota, legjenda, këngë lirike dhe historike nga letërsia gojore shqiptare. Cikli i Kreshnikëve. - Naim Frashëri "Bagëti e	- Përralla, gjëegjëza, anekdota, legjenda, këngë lirike dhe historike nga letërsia gojore shqiptare. Cikli i Kreshnikëve. - Kanuni i Lekë Dukagjinit.

Alisë. - Zef Serembe “Vepra” (poezia “Detari”). - Jeronim De Rada “Skënderbeu i pafat”. - Sami Frashëri “Besa e shqiptarit”. - Pashko Vasa “O moj Shqypni”. - Bajron “Shtegtimet e Çajld Harold”. - Filip Shiroka “Shko dallëndyshe”. - Gjergj Fishta “Mrizi i zanave” (poezia “Gjuha shqype”). - Fan Noli “Album” (poezia “Himni i flamurit”). - Lumo Skëndo “Hi dhe shpuzë”. - Lasgush Poradeci “Vallja e yjeve” (poezia “Kroi i fshatit tonë”). - Faik Konica “Vepra” (proza “Malli i atdheut”). - Ernest Koliqi “Hija e maleve” (proza “Kërcimtarja e Dukagjinit”). - Mitrush Kuteli “Pylli i gështenjave” ose “Xinxifillua”. - Anton Papleka “Legjenda e tregime të moçme shqiptare” - Mihal Hanxhari “Vepra” (poezia “Elegji për Kosovën”). - Xhevair Spahiu “Vepra” (poezia “Ligjërimi i bariut mbi qenin pa jetë”. - Visar Zhiti “Si shkohet në Kosovë?”. - Jusuf Gërvalla, “Fluturojnë e bien” (poezi). - Nazmi Rrahmani “Rruga e shtëpisë sime”.	bujqësi”. - Adreni “Lulëkuqja” (mbledhur nga Xh. Spahiu”). - Mitrush Kuteli “Prozë dhe poezi e zgjedhur”. - Migjeni “Vargjet e lira”. - Lasgush Poradeci “Ylli i zemrës”. - Ernest Koliqi “Tregtarë flamujsh”. - Mehmet Kraja “Zhvarrimi” (prozë) - Kim Mehmeti “Lulehëna” (prozë). - Bilal Xhaferri “Vdekja në udhët e Çamërisë” (prozë). - Ali Asllani “Vepra” (poezia “Vajzat heqin valle”). - Ali Podrimja “Lum Lumi”. - Rrahman Dedaj “E marta” (poezi). - Xhevahir Spahiu “Vepra” (poezia “Shkopi i Gjeçovit”). - Aleksandër Moisiu “Debutimi im në Burgteatër” (prozë). - Ekrem Kryeziu “Epoka para gjyqit”. - Din Mehmeti “Që të rriten lulet e bardha” (poezi). - Rexhep Qosja “Beselam pse më flijojnë” (fragment drame). - Abdylazis Islami “Anija e kapitenit Balltar” (prozë). - Ramiz Kelmendi “Miniatura nga Turqia” (udhëpërshkrim). - Dritëro Agolli “Nënë Shqipëri”. - Ismail Kadare “Kronikë në gur”. - Fatos Arapi “Antologji personale”. - Ali Podrimja “Lum Lumi” (poezia “Me jetue”). - Qerim Ujkani “Kthimi i ushtarit në shtëpi” (poezi). - Arif Demolli “Vdekja e Akanit” (prozë). - Zejnullah Rrahmani “Drita e diellit” (prozë).	- Marin Barleti “Histori e Skënderbeut”. - Pjetër Bogdani “Vepra” (poezia “Rruzullimi”). - Jeronim De Rada “Këngët e Milosaos”. - Naim Frashëri “Vjersha për mësonjëtoret e para” (poezia “Fjalët e qiririt”). - Ndre Mjeda “Andrra e jetës”. - Asdreni “Poezi të zgjedhura”. - Çajupi “Baba Tomorri”. - Serembe “Vepra” (poezia “Vrull”). - Gjergj Fishta “Lahuta e Malcis”. - Fan Noli “Album” (poezia “Anës lumenjve”). - Migjeni “Vargjet e lira”. - Mitrush Kuteli “Vepra të zgjedhura” (Poemi kosovar). Lasgush Poradeci “Lirika” (poezia “Vdekja e nositit”). - Et’hem Haxhiademi “Skënderbeu”. - Ernest Koliqi “Hija e maleve”. - Jakov Xoxa “Lumi i vdekur”. - Xhevahir Spahiu “Zogj të kaltër”. - Dritëro Agolli “Vepra” (poezia “Kur të jesh mërzitur shumë”. - Ismail Kadare “Kush e solli Doruntinën”. - Ismail Kadare “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”. - Fatos Arapi “Vepra” (poezia “Atdheu”). - Beqir Musliu “Skënderbeu” (poezi). - Anton Pashku “Lutjet e mbrëmjes” (prozë). - Bilal Xhaferri “Përtej largësive”. - Rexhep Qosja “Laneti”. - Azem Shkreli “Motiv nga Kosova”. - Ali Podrimja “Fatet” (poezi). - Fatos Kongoli “I humburi”. - Sabri Hamiti “Ikja e barbarëve’. - Viktor Canosinaj “Meri yll”.

- Petro Marko “Shpella e piratëve”. - Martin Camaj “Një fyell ndër male”. - Iliaz Bobaj “Legjenda e Butrintit”.	- Eqrem Basha “Baladë për njeriun që zgjohej me shpresë” (poezi). - Agim Spahiu “Këtu” (poezi) - Azem Shkreli “Nata e mërgimtarëve” (poezi). - Sabri Hamiti “Vaji për Prishtinën” (poezi). - Bardhyl Xhama “Djaloshi që kapte rrufetë”. - Klara Kodra “Ku janë zanat”. - Andrea Petromilo “Qielli i murrëtyer i së dielës”.	

Histori

Burimet themelore të të nxënit janë tekstet dhe materialet e tjera mësimore që do të hartohen në bazë të kësaj kurrikule si dhe:

- tekstet dhe mjetet e tjera mësimore që përdoren në Shqipëri e në Kosovë;
- tesktet e botimet e tjera historike në harmoni me këtë kurrikul;
- hartat historike;
- atlaset historikë;
- albumet e ndryshme;
- filmat mësimorë (dokumentarë e artistikë me funksion edhe mësimor);
- fotografi, posterë, skica, diagrame, tabela;
- uebfaqe të ndryshme, portale didaktike;
- kompjuteri, interneti, androidë të ndryshëm, CD e pajisje të tjera multimediale.

Ja një listë me njësi të rekomanduara bibliografike.

- **Historia e popullit shqiptar. Vëllimi 1.** Ilirët, Mesjeta, Shqipëria nën Perandorinë Osmane gjatë shek. XVI - vitet 20 të shek. XIX Autori: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë. Shtëpia botuese "Toena". Viti i botimit 2002, faqet e librit 806. ISBN 99927-1-622-3.
- **Historia e popullit shqiptar. Vëllimi 2**. Rilindja Kombëtare. Vitet 30 të shek. XIX - 1912. Autori: Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Shtëpia botuese: "Toena". Viti: 2002, faqet e librit 604. ISBN 99927-1-623-1.
- **Historia e popullit shqiptar. Vëllimi lll** Periudha e pavarësisë 28 nëntor 1912 - 7 prill 1939. Autori: Akademia e Shkencave te Shqipërisë. Shtëpia botuese: Toena. Viti i botimit 2007. Faqet e librit 600. ISBN 978-99943-1-269-6.
- **Historia e popullit shqiptar. Vëllimi IV**. Shqiptarët pas Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj (1939 - 1990). Autori: Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Shtëpia botuese: Toena. Viti i botimit 2009. Faqet e librit 480. ISBN 978-99943-1-452-2.
- **Harta arkeologjike e Shqipërisë.** Grup autorësh. Botuesi: Akademia e Shkencave të Shqipërisë.
- **Harta arkeologjike e Kosovës** me autorë: Luan Përzhita, Kemajl Luci, Gëzim Hoxha, Adem Bunguri, Fatmir Peja, Tomor Kastrati. Botuesi: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës - Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Faqet e librit 395. Prishtinë, 2006.

- **Guidë Arkeologjike e Kosovës,** Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Instituti Arkeologjik i Kosovës, Prishtinë, 2012.
- **Katalogu Arkeologjik i Kosovës,** Muzeu i Kosovës dhe Instituti Arkeologjik i Kosovës, Prishtinë, 2013.
- "Komunizmi përmes dokumenteve arkivore: Represioni në periudhën e vetizolimit" (material per mesimdhenes dhe nxenes), redaktuar nga: Idrit Idrizi, Jonila Godole, Fatmiroshe Xhemalaj, Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë (IDMC),Tiranë, 2017.
- Zijadin Gashi, Shtëpitë shkolla në fotografi, Libri Shkollor, Prishtinë, 2017.
- Luisa Black, Mësimdhënia e historisë sot (qasje dhe metodat), Këshilli i Evropës, Prishtinë, 2011.

Adresa dhe burime në internet

- www.albasoul.com/historia/
- www.albanian.com/information/history/
- www.shqiperia.com/histori/
- www.dadalos.org
- http://qsa.edu.al/site/ih/ page_id=510 (Akademia e Studimeve Albanologjike;Instituti i Historisë)
- http://www.mhk.gov.al/(**Muzeu Historik Kombëtar**)
- http://new.albarchive.gov.al/ (Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave)
- http://muzeumetkruje.gov.al/(Muzeu Historik Kombëtar "Gjergj Kastriot Skëndërbeu" dhe Muzeu Etnografik)
- http://muzeumesjetar.gov.al/(Muze Korçë)
- http://muzeugjethi.gov.al/ (Muzeu Kombëtar "Shtëpia me Gjethe")
- www.dardamedia.com/art (Muzeu Etnologjik)
- www.albmuseum.com (Muzeu Kombëtar Tiranë)
- www.angelfire.com/dc/madurres (Muzeu Arkeologjik Durrës)
- www.beratmuseum.gov.al/muze/Muze.etno.htm(Muzeu Etnografik Kombëtar, Berat)

Gjeografi

Burimet themelore të të nxënit janë tekstet dhe materialet e tjera mësimore që do të hartohen në bazë të kësaj kurrikule si dhe:

- tekstet dhe mjetet e tjera mësimore që përdoren në Shqipëri e në Kosovë;
- tesktet e botimet e tjera gjeografike në harmoni me këtë kurrikul;
- atlaset shkollorë;
- globi shkollor;
- harta (fizike, politike, ekonomike) të hapësirave shqiptare etj.
- fotografi, posterë, skica, diagrame, tabela;
- filma mësimorë dokumentarë etj.;
- uebfaqe të ndryshme, portale didaktike;
- kompjuteri, interneti, androidë të ndryshëm, CD e pajisje të tjera multimediale.

Kulturë figurative dhe kulturë muzikore

Si burime themelore të të nxënit konsiderohen tekstet dhe mjetet e tjera mësimore të hartuara sipas kësaj kurrikule si dhe:

- tekstet, mjetet mësimore dhe literatura ndihmëse sipas niveleve dhe grup-moshave të kësaj kurrikule, që përdoren në Shqipëri dhe në Kosovë;
- një mori burimesh të tjera për kulturën figurative me katalogë të ndryshëm, CD, DVD, fotografi, posterë e mjete të tjera ilustruese që pasqyrojnë parqet dhe mjediset shqiptare, banesat dhe objektet shqiptare, veshjet tradicionale shqiptare, figurat e shquara të kombit shqiptar (portrete *pikturë, skulpturë)*etj.;
- *albume* me vepra nga autorët më të shquar të artit pamor shqiptar që kanë punuar mbi tematika dhe përmbajtje të caktuara (peizazh nga natyra dhe mjedisi i kombit shqiptar, parqet natyrore, monumentet kulturore, objektet dhe ndërtesat shqiptare, portrete nga figura të shquara të kombit shqiptar, veshjet tradicionale shqiptare etj.);
- pajisje për dëgjimin dhe mësimin e këngëve të ndryshme (këngë për fëmijë kushtuar *atdheut, shokëve festave, natyrës, shkollës, nënës, mësueses etj.;* këngë e lojëra popullore për fëmijë, rituale popullore për fëmijë, himnin dhe këngë të tjera patriotike shqiptare, këngë popullore dhe të kultivuara shqiptare, këngë të lehta lirike etj.);
- pajisje me ligjërime ritmike të thjeshta për fëmijë;
- pajisje për dëgjimin e veprave muzikore të kompozitorëve të shquar shqiptarë;
- CD, DVD, fotografi, posterë e mjete të tjera ilustruese për muzikën shqiptare etj.;
- një katalog të zgjedhur me kujdes nga mësuesja të njësive artistike skenike shqiptare (film, balet, valle, teatër etj.).

Katalog i rekomanduar veprash të veçanta muzikore:

NIVELI I PARË	**NIVELI I DYTË**	**NIVELI I TRETË**
***KËNGË* - INTERPRETIM:** - *Himni i Flamurit.* - *Himni i Kosovës.* - Për mëmëdhenë (patriotike). - F. Ibrahimi, *Fjala "Nënë".* - *V'lla i dashur ose Vëlla Arbër* (kanon i njohur i shqipëruar). - I. Shehu, *Bilbili dhe gjinkalla.* - T. Daja, *Simfonia e kafshëve.* - D. Rudi, *Dy duar, tre fëmijë.* - R. Sokoli, *Fyelli i bariut* (këngë). - **Lojëra muzikore/ligjërime** - **ritmike:** Ritual popullor - Shi shi Baba shi; Ritual popullor - Rona rona peperona.	***KËNGË* - INTERPRETIM:** - *Alfabeti shqip* (patriotike). - M.Piperku, *Nëna Tereze.* - Bektashi, *Vjosa.* - P. Badivuku, *Duar të arta ke.* - R. Dhomi, *Pse jemi të ndarë?* - Sh. Kushta , *Jona , Jona Peperona.* - F. Shubert, *Nina nana* (e shqipëruar). - G. Avrazi, *Atdheu.* - *V. Nova , O mësues i dashur.* - A. Mula, *Këngа e gjyshes.* - R. Sokoli, *Fyelli i bariut* - **Lojëra muzikore/ligjërime** - **ritmike:** Ritual popullor - Hu hu baba hu. Orolinga torolinga-ligjërim ritmik	***KËNGË* - INTERPRETIM:** - P. Gaci, *Për ty atdhe.* - *Ç.* Zadeja, *Asaman o trandofili çelës.* - F. Abt, *Lulja e fshehur* (dyzëreshe e shqipëruar). - S. Gjinali, *Mema.* - P. Gaci, *Për ty atdhe* (këngë).
DËGJIM MUZIKË: - F. Beqiri, *Ninulla*	**DËGJIM MUZIKË:** - Z. Ballata, *Nënës* (kor).	**DËGJIM MUZIKË:** - V. Gjini, *Vashë me sytë e zi* (korale). - Koci, *Këngа e Rexhes* (korale). - L. Antoni, *Valle shqiptare* (orkestrale). - R. Mulliqi, *Simfonia nr. 2 kosovare.* - Ç. Zadeja, *muzika e filmit Skëndërbeu.* - F. Ibrahimi, *Tokata për piano.* - A. Mula, *Agimet*

- T. Harapi ,*Trëndafili i vogël.* - T. Daija, *Balerina e vogël* (piano). - R. Rudi, *Pasaporta e dacit* .	- L. Antoni, *Corapet e burrit* (këngë korale). - F. Ibrahimi, *Rapsodia shqiptare* (orkestrale). - R. Rudi, *Një kokë, një tokë* (korale). - M. Kacinari, *Fyelli i bariut* (piano).	*shqiptare.* - R. Rudi, *Ne kemi një tokë.* - K. Alickaj, *Ilyricum, Simfoni.*
***KËNGË* - INTERPRETIM:** - F. Beqiri, *Zilja jonë.* - L. Deda, *Moj bubrrec.* - M. Basha, *Gëzimi i shkollës.* - S. Ishmaku, *Are, are abetare.* - N. Kaba, *Mësuesja ime.* - **Lojëra muzikore/ligjërime ritmike.**	**KËNGË - INTERPRETIM** - Alfabeti shqip, Patriotike. - L.Dizdari, *Fluturojme të dy tok.* - Sh. Krypa, *Lule për mësuesen.* - V. Beqiri, *Biçikleta.* - M. Piperku, *Lamtumirë.* - **Lojëra muzikore/ligjërime ritmike:** *Ejani flutura, vasha të bukura; Lakuriqi natën; Shoqe eja të kërcejmë; Loja e shqiponjave.*	**KËNGË - INTERPRETIM** - Xh. B. Pergolezi, *Lulja e bukur* (e shqipëruar). - *Të gëzojmë* (qytetare). - L. V. Bethoven, *Gjumi i natës* (e shqipëruar).
***KËNGË* - INTERPRETIM:** - M. Qafleshi, *Prishtina.* - Hoxha, *Ora.* - Hoxha, *Marsi.* - Z. Ballata, *Dimri* - P. Badivuku, *Lulet në mars.* - Goca e Preshevës (popullore). - B.Mulliqi, *Rik, rik, rik.* - S. Gjinali, *Stinët, muajt e ditët.* - **Ligjërime ritmike:** *Flutur, flutur zonjë e bukur; Mori lulja e linit* (popullore). **DËGJIM MUZIKE:** - M. Kacinari, *Drandofilja e vogël.* - P. Gaci, *Koncert për violinë e orkestër* (koha e III).	***KËNGË* - INTERPRETIM:** - *Për mëmëdhenë* (patriotike). - R. Rudi, *Sa pyje male.* - B. Mulliqi, *Pushimet dimërore.* - *Ja, iku dimri* (zvicerane e shqipëruar). - R. Sokoli, *Balonat.* - F. Seli, *Këngë e cicërimë.* - M. Piperku, *Zogjtë dhe flatrat.* - **Këngë Popullore:** - Popullore, *A kanë uj'ato burime* (9/8). - Popullore, *Po shkon goca me korr'n'are* (7/8). - Popullore, *Rrush i kuq* (9/8). - Popullore, *Kënga e ftujkës.* - Popullore, *Mora rrugën për Janinë.* - Popullore, *Erdhi prilli.*	***KËNGË* - INTERPRETIM:** - M. Piperku, *Pranvera ne Prishtinë.* - *Kroi i fshatit tonë* (qytetare). - P. Jakova, *Dielli ka prendue* (aria nga opera "Mrika"). - S. Spahiu, *Pamje vjeshte.* - L. V. Bethoven, *Muzgu* (e shqipëruar). - K. Trako, *Drini plak..* **DËGJIM MUZIKE:** - R. Mulliqi, *Baresha.* - F. Beqiri, *Poema dramatike* "Skëndërbeu". - P. Jakova, aria "nga opera. - V. Beqiri, *Gjergj Kastrioti.* - A. Koci, *Muzikë nga baleti "Sokoli e Mirushja"*
***KËNGË* - INTERPRETIM:** - S. Qefa, K*ënga jonë në festival.* - V. Filaj, *Viti i ri.* - Grimci, *Një Qershori.* - *Xhaxhi këngën ma mëso.* - *Zilja tring* (Jingle Bell – këngë angleze e shqipëruar). **DËGJIM MUZIKE:** - M. Kacinari, *Suita ilire.* - *Valle shqiptare.* - Melodi instrumentale shqiptare; orkestrina popullore, veglat e ndryshme muzikore (çifteli, fyell, def etj.).	**DËGJIM MUZIKE:** - R. Mulliqi, *Akuarelet e Prizrenit.* - M. Menxhiqi, Oratoriumi: *Homazh Nënës Terezë.* - Ç. Zadeja, *Simfonia nr. 1.* - F. Ibrahimi, *Koncert për violongel dhe orkestër.* - F. Beqiri, *Sonata per klarinete e piano.* - V. Gjini, *Këngë solo "Letrat";* - L. Disdari, *Trio për violinë, violonçel dhe piano.* - R. Rudi, *Afresk* arbëresh.	***KËNGË* - INTERPRETIM:** - Th. Nasi, V*lora o Vlora* (patriotike). - S. Gjoni, *Lule bore.* - Popullore, *O po gjeta një bilbil në vesë* (7/8). - *Dola n'bahçe* (nga tradita fshatare). - *Njëzet e pesë gërsheta, popullore.* - *Këndon zogu* (interpretim dyzësh).

	***KËNGË* - INTERPRETIM:** - *Kënga e flamurit.* - *Oj lum e lum po vjen Shëngjergji.* - Popullore, *Lul'e kuqe, lul' bojë pembe* (5/8). - *Lule Bore* (këngë popullore shkodrane).	
	DËGJIM MUZIKE: - E. Rizvanolli, *Suita për piano -suita dasmore* (muzika kombëtare). - F. Beqiri, *Marshi "Ala Turca".* - Sh. Kushta, *Fantazi për violonçel dhe orkestër* (muzika kombëtare). - A. Koci, *Oj llokumja* (korale).	**DËGJIM MUZIKE:** - R. Mulliqi, pjesë instrumentale, *Muzike nga baleti "Nita".* - Z. Ballata, *"Jehona nga bjeshkët e Nemuna"* (për piano). - K. Trako, *Poema simfonike "Vendi im".* - E. Rzivanolli, *Kuarteti i harqeve.* - B. Jashari, *Pasakalja për orkestër.* - *M. Menxhiqi "Nënë Tereza" –Oratorium*

Katalog i rekomanduar veprash të veçanta të kulturës figurative

NIVELI I PARË	NIVELI I DYTË	NIVELI I TRET
- Adem Kastrati, *Motiv nga fshati.* - Alush Shima, *Horizonti i kaltër.* - Agim Cavdarbasha, *Sofra.* - Shyqri Nimani, *Mbrojeni natyrën.* - Simon Shiroka, *Lojërat popullore shqiptare.* - Agim Rudi, *Plisat.* - Musa Klaveshi, *Gongje për Gongjen.* - Vehap Kokalari, *Prite, prite Azem Galicën.* - Nimona Lokaj, *Pishat e Deganit.* - Vilson Kilica, *Peisazh nga Myzeqeja.* - Abdurrahim Buza, *Lojëra popullore.* - Vangjush Mio, *Vjeshtë me udhëtarë*, peizazh. - Vangjush Mio, *Tirana*, peizazh. - Vangjush Mio, *Dimër në Korçë.* - Vangjush Mio, *Fusha e Korçës.* - Simon Rrota, *Artizan terzi.* - Danish Jukniu, *Barinjtë në bjeshkë.* - Esat Valla, *vizatime.*	- Zef Shoshi, *Isa Boletini me trimat.* - *Hyjnesha në fron*, (simboli i Prishtinës). - Zef Kolombo, *Autoportreti i piktorit.* - Xhevdet Xhafa, *Autobiografia.* - Muslim Mulliqi, *Hamalli.* - Sali Shijaku, *Mic Sokoli.* - Ismet Jonuzi, *Kënga e Rexhës.* - Kolë Idronemo, *Dasma shkodrane.* - *Destan Gashi, Hasjanja duke i dhënë gji foshnjës* - Esat Valla, *Nusja.* - Rexhep Goci, *Ura e Shejte.* - Violeta Xhaferi, *Drenicakja.* - Kolë Idromeno, *Motra Tone.* - Sadik Kaceli, *Dasëm tiranase.* - Odise Paskali, *Luftëtari kombëtar.* - Gazment Leka, *Rozafati.* - Gazment Leka, *Tregime të moçme shqiptare, ilustrime.* - Ismail Lulani, *Portret malësoreje.* - Ismail Lulani, *Kreshnikët (Muji dhe Halili).* - Ismail Lulani, *Zadrimorja* - *Guri Madhi, Nëna.* - Nexhmedin Zajmi, *Nëna me dy fëmijët.* - *Familja e fotografëve*	- Andrea Kushi, *Plaku me shkop.* - Abdurrahim Buza, *Dasëm me flamur.* - Odhise Paskali, *Busti i Skëndërbeut.* - Janaq Paço *Skëndërbeu mbi kalë, në Tiranë.* - Janaq Paco, *Statuja e Skëndërbeut në Prishtinë.* - Rexhep Ferri, *Shëtitësit e lodhur.* - Gjelosh Gjokaj, *Vija e kuqe.* - Nebih Muriqi, *Peizazh* - *Gani Gashi, Mozaik ilir* - Ëngjëll Berisha, *Shqiponjat e përqafuara.* - Ismet Jonuzi, *Skulpture.* - Afrim Spahiu, *Pa titull /fotografi/* - Shyqri Nimani, *Universiteti i Prishtinës.* - Thomas Philips, *Bajroni me veshje shqiptare.* - Abdurrahim Buza, *Refugjatët.* - Ibrahim Kodra, *Shqipëria fantastike (cikli Muziktarët").* - Abdurrahim Buza, *Kuvendi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.* - Abdurrahim Buza, *Azem Galica me trimat.* - Ismail Lulani, *Shote Galica.* - Ismail Lulani, *Drejt Vlorës heroike.* - Pandi Mele, *Portret i Skënderbeut* - Hysen Devolli, *Dorëzimi i armëve nga turqit.* - Nexhmedin Zajmi, *Malësori.* - Abdurrahim Buza, *Shqipëria*

	Marubi, Shkodër. - *Pejzazhe nga autorë të ndryshëm nga Shqipëria dhe nga Kosova.* - Zake Prelvukaj, *Geto në Ballkan.*	*vallëzon.*

12.PLANI MËSIMOR ORIENTUES

Ky plan është vetëm orientues dhe nuk pretendon të jetë përcaktues (as favorizues, as përjashtues) në aspektin e rëndësisë së lëndëve a fushave mësimore. Vetë karakteri integrativ dhe ndërveprues i mësimit, i cili të shumtën do të jetë një mësim i diferencuar, i relativizon skemat e përqindjeve konvencionale të përcaktuara apo të paragjykuara paraprakisht. Pra, në këtë kontekst shmanget edhe rreziku i krijimit të përshtypjes së gabuar të "dominimit" të gjuhës shqipe, sepse, fundja, një shumicë rezultatesh të të nxënit (edhe të lëndëve të tjera) realizohen përmes kësaj lënde.

Plani orientues i përgjithshëm i orëve sipas fushave/lëndëve

Nr.	Lëndët-fushat mësimore	Numri vjetor i orëve sipas niveleve		
		Niveli i parë	Niveli i dytë	Niveli i tretë
1	Gjuhë shqipe	46	46	46
2	Histori	4	8	8
3	Gjeografi	4	7	7
4	Kulturë muzikore	10	6	6
5	Kulturë figurative	7	4	4
6	Fusha të tjera	1	1	1
GJITHSEJ		**72**	**72**	**72**

Plani orientues i orëve të gjuhës shqipe

Niveli	Klasat	Numri vjetor i orëve	Leximi dhe shkrimi fillestar	Letërsi	Gjuhë	Kulturë e të shprehurit	Kulturë mediale dhe komunikim
I	1	46	34	4	4	3	1
	2	46	7	17	10	10	2
	3	46	7	17	10	10	2
II	4	46		23	11	10	2
	5	46		23	11	10	2
	6	46		23	11	10	2
III	7	46		23	11	10	2
	8	46		23	11	10	2
	9	46		23	11	10	2